Migjeni
(Millosh Gjergj Nikolla)

Vargjet e lira

Të Bijte e Shekullit te Ri

Na te birte e shekullit të ri,
qe plakun e lame ne "shejtnin" e tij
e cuem grushtin për me luftue
nder lufta të reja
dhe me fitue...
Na te birte e shekullit të ri,
filizat e një toke se rimun me lot,
ku djerse e ballit u dikonte kot
se dheu ynë qe kafshate e huej
dhe ne marrzi duhej shum shtrejte t'u paguhej.
Na te birte e shekullit të ri,
vllazen te lindun e te rritun ne zi,
kur tinglloi çast' i ynë i mbrame
edhe fatlume
ditem me thanë :
S'duem me humbe
ne loje te pergjakte te historis njerzore,
jo! jo! s'i duem humbjet prore
duem ngadhnim!
ngadhnim, ndërgjegje dhe mendimi te lirë!
S'duem, për hirë
te kalbsinave te vjetra, qe kërkojnë "shejtnim",
te zhytemi prap ne pellgun e mjerimit
qe te vajtojme prap këngën e trishtimit,
këngën monotone, pa shpirt, te sklavnis
te jem' një thumb i ngulun nder trute e njerzis.
Na te birte e shekullit të ri,
me hovin ton e te ndezun peshe,
nder lufta të reja kemi m'u ndeshe
dhe për fitore kem' me ra fli.

Kanga e Rinise

Rini, thueja kanges ma te bukur qe di!
Thueja kanges sate qe te vlon ne gji.
Nxirre gezimin tand' te shpertheje me vrull...
Mos e freno këngën! Le të marri udhe.

Thueja kanges, rini, pash syt e tu...
Të rroki, te puthi kënga, te nxisi me dashnu
me zjarrm tand, rini... Dhe te na mbysi dallga
prej ndjenjash te shkumbzueme q'i turbullon kënga.

Rini, thueja kanges dhe qeshu si femi
Kumbi i zanit te perplaset për qielle
dhe te ktheje prap te na, se hyjt ta kanë zili

e na te duem fort si te duem një diell.
Thueja kanges, Rini! Thueja kanges gezimplote!
Qeshu, rini! Qeshu! Bota është e jote.

Poema e Mjerimit

Kafshate qe s'kaperdihet është, or vlla, mjerimi,
kafshate qe te mbete ne fyt edhe te ze trishtimi
kur shef ftyra te zbeta edhe sy te jeshilta
qe te shikojne si hije dhe shtrijne duert e mpita
edhe ashtu te shtrime mbrapa teje mbesin
te tanë jetën e vet derisa te vdesin.
E mbi ta n'ajri, si ne qesendi,
therin qiellen kryqat e minaret e ngurta,
profetent dhe shejtent ne fushqeta te shumngjyrta shkelqejne.
E mjerimi mirfilli ndien tradhti.
Mjerimi ka vulen e vet te shemtueme;
është e neveritshme, e keqe, e turpshme;
balli qe e ka, syt qe e shprehin,
buzët qe me kot mundohen ta mshefin
janë femite e padijes e flite e perbuzjes,
te mbetunat e flliqta rreth e perqark tryezes
mbi te cilën hangri darken një qen e pamshirshem
me bark shekulluer, gjithmon i pangishem.
Mjerimi s'ka fat. Por ka vetëm zhele,
zhele fund e maje, flamujt e një shprese
te shkyme dhe te coptuem me te dalun bese.
Mjerimi terbohet ne dashuni epshore.
Neper skaje t'errta, bashke me qej, mij, mica,
mbi pecat e mykta, te qelbta, te ndyta, te lagta
lakuriqen mishnat, si zhange; te verdhe e pisa;
kaperthehen ndjenjat me fuqi shtazore,
kafshojne, perpijne, thithen, puthen buzët e ndragta
edhe shuhet uja, dhe fashitet etja
n'epshin kaperthyes, kur mbytet vetvetja.
Dhe aty zajne fillin te marret, sherbtoret dhe lypsat
qe nesër do linden me na i mbushe rrugat.

Mjerimi ne dritzen e synit te kerthini
dridhet posi flaka e mekun qirini
nën tavan te tymuem dhe plot merimanga,
ku hije njerzish dridhen nder mure plot danga,
ku foshnja e smueme qan si shpirt' i keq
tu' nduke gjite e shterruna te se zezes ame,
e kjo prap shtazane, mallkon zot e dreq,
mallkon frytn e vet, mallkon barrn e rande.
Foshnj' e saj nuk qesh, por vetëm lengon,
e ama s'e don, por vetëm mallkon.
Vall sa i trishtueshem është djepi i skamit
ku foshnjen perkundin lott edhe te fshamit!
Mjerimi rrit femin ne hijen e shtepive
te nalta, ku nuk mrrin zani i lypsis,
ku nuk mund t'u prishet qetsia zotnive
kur bashke me zoja flejne ne shtretent e lumnis.

Mjerimi pjek femin para se te burrnohet;
don ta msoje t'i iki grushtit q'i kercnohet,
atij grusht qe ne gjume e shterngon për fytit
kur fillojnë kllapite e etheve prej unit
dhe fytyren e femis e mblon hij' e vdekjes,
një stoli e kobshme në vend te buzqeshjes.
Një fryt kurse piqet dihet se ku shkon
qashtu edhe femia ne bark te dheut mbaron.
Mjerimi punon, punon dit e nate
tu' i vlue djersa ne gjoks edhe ne ballë,
tue u zhigatun deri ne gjuje ne balte
e prap zorret nga uja i bahen pale-pale.

Shperblim qesharak! Për qindenje afsh
ne ditë vetëm: Lekë tre-katër dhe "marsh!".
Mjerimi kaiher' i ka faqet e lustrueme,
buzët e pezmatueme, mollzat e ngjyrueme,
trupin permendore e një tregtis se ndyte,
qe është i gjikuem te bije ne shtrat te vet i dytë;
dhe për at sherbim ka për te marrë do franga
nder çarçafe, nder fetyra dhe ne ndërgjegje danga.
Mjerimi gjithashtu len dhe ne trashigim
jo veç nëpër banka dhe ne gja te patundshme,
por eshtnat e shtrembta e ne gjoks ndoj dhimbe,
mund qe te len kujtim ditën e dikurshme
kur pullaz' i shtepis u shemb edhe ra
nga kalbsin' e kohës, nga pesha e qiellit,
kur mbi gjithçka u ndi një i tmerrshmi za
plot mallkim dhe lutje si nga fund i ferrit,
ish zan' i njeriut qe vdiste nën tra.
Kështu nën kambe te rande te zotit t'egersuem
thotë prifti vdes ai qe çon jetë te dhunuem.
Dhe me këto kujtime, ksi lloj fatkeqesinash
mbushet got' e helmit ne trashigim brezninash.
Mjerimi ka motër ngushulluese goten.
Ne pijetore te qelbta, pranë tryezes plot zdrale
te neveritshme, shpirti me etje derdh goten
ne fyt për me harrue nandhetenand' halle.
E gota e turbull, gota satanike
tu' e ledhatue e pickon si gjarpni
dhe kur bie njeriu, si gruni nga drapni,
nën tryeze qan-qeshet ne formë tragjikomike.
Të gjitha hallet skami ne gote i mbyt
kur njeqind i derdh një nga një ne fyt.

Mjerimi ndez dëshirat si hyjet errsina
dhe bajne tym si hejt q'i ban shkrum shkreptima.
Mjerimi s'ka gezim, por ka vetëm dhimba,
dhimba paduruese qe te bajne te cmendesh,
qe t'apin litarin te shkojsh fill' e te varesh
ose bahe fli e mjerë e paragrafesh.
Mjerimi s'don mshire. Por don vetëm te drejt!
Mshire? Bije bastardhe e etenve dinake,
te cilt ne mnyre pompoze posi farisejt
i bijne lodertines me ndjejt dhelparak
tu' ia leshue lypsiti një grosh te holl' ne shplake.
Mjerimi është një njolle e pashlyeme
ne ballë te njerzimit qe kalon nëpër shekuj.
Dhe ket njolle kurr nuk është e mundshme
ta shlyejne pacavrat qe zune myk nder tempuj.

Lutje

Të lutem, o perendi,
për një simfoni
me tinguj t'argjante
e akorde t'arte.

Të lutem, o perendi,
për një simfoni
plot dashuni
te nxehte si te vasha gjite
kur vlojne ndijesite.

Të lutem, o perendi
për një simfoni
te defrej ne lumni
t'u u perkunde n'ani
te bukur t'andrrimeve
te kalter, ku te fantazmeve
buzët me tërheqin zjarrte
e me digjen syt e flakte.

Të lutem, o perendi,
për një simfoni
e kurr, e kurr ma mos te zgjohemi.

Zgjimi

O vullnete te ndrydhuna nder grushta te celikta te shekujve
te kaluem!
O vullnete te shtypuna me themra te ngurta te titajve te terbuem!
Te cilet n'udhe per ne theqafje ketejpari i rane
dhe vatrat tona ne mjerim i perlane...
O vullnete te ndrydhura!
O vullnete te shtypuna!
Shkundni prangat te mbrapshta! E me brime ngadhnyese,
me hove viganash, deshirash flatruese,
turniu ne te gjitha anet dhe poshte ne dhe zbritni
- ndosht' aty keni per te gjete fillin e nje hymni,
qe Illyri e vjeter nder kremtime kendonte,
ndersa zemra e kombit ne liri kumbonte.
O vullnete te ndrydhuna!
O vullnete te shtypuna!
Tash shegjetat e flakta te shprehjes suej zharitse
drejtoni kah qiella ne ball te hyut a te dreqit,
i cili fatin tone mbytte ne mnije te vet perpise -
Ta dije se te Birt' e Shqipes folen ia ngrehen vetvetit.

Pesha e fatit

Na shtypi fati e na bani krymba
ne kensit dykambesh qe zbuluem hy'n
edhe aq me teper e ngaterruem ny'n...
shpirtent tone skyfera deshen te bahen pellumba.

(Rrini, mos skyfera! Pse te baheni pellumba?
Mizat e parajsit ne jeten mbrapa vorrit
kane me iu merzitun -- dhe mandej prej zorit
do te pelcisni... Prandej: pse te baheni pellumba.)

Fat i yne mizor -- shpate e Damokleut
Si vall! Te gjitha perpjekjet na deshtuen ne terr?
E jeta na bahet ma zi se sketerre.
Te vertetat, as rrenat, s'i ndihmuen Dheut.

Te vertetat dhe rrenat? -- Xhevahiret e cmuem
Me ta kur te duesh e shet dhe e blen boten.
Por mos mendo se me ta do t'ia ndreqish rroten...
Jo se i pelqen jetecale me shkuem.

Me calue n'ane te djathte, me calue n'ane te majte...
Si paljaco i gjore qe kah t'ia mbaje s'di,
mbasi kamben e theu ne akrobaci --
jet' e tij asht helm me asnje pike mjalte.

Nen flamujte e melankolise

Ne vendin tone
kudo valojne
flamujt e nje melankolie
te trishtueshme...
...dhe askush s'mund te thote
se ketu rron
nje popull qe nderton
dicka te re.
Aty ketu ne hijet
e flamujve
mund te shifet
nje mund, nje perpjekje
e madhe permbi vdekje
per te pjelle dicka te madhe
per qe qite ne drite nje xhind!
Por, (o ironi)
nga ajo perpjekje lind
vetem nje mi.
Dhe keshtu kjo komedi
na plas diellin e gazit,
nsa prej marazit
pelcasim.

Ne prakun e cdo banese
ku ka ndoj shenj jetese
valon nga nje flamur
melankolie te trishtueshme.

Por nuk vdes shampanja!

U linden milionet
me miliarde deshira,
Kuj t'i leshohet radha
kur nuk ka batalla?

Por do te kete Karrnera
dhe do te kete poeten
gjithashtu edhe priften.

Prifti ka per te thane:
ku do te shkoje
ai qe e coi
jeten si nje gote shampanje
e ku ai me te thyeme dhambe?

Recital i Malesorit

O, si nuk kam një grusht te fortë
t'i bij mu ne zemër malit qe s'bezane,
ta dij dhe ai se c'domethane i dobët -
n'agoni te perdihet si vigan i vrame.

Unë lugat si hij' e trazueme,
trashigimtar i vuejtjes dhe i durimit,
endem mbi bark te malit me ujen e zgjueme
dhe me klithma te pakenaqura t'instinktit.

Mali hesht. Edhe pse përditë
mbi lekure te tij, ne loje varrimtare,
kerkoj me gjete një kafshate ma te mirë...
Por me rren shaka, shpresa genjeshtare.

Mali hesht, dhe ne heshtje qesh.
E unë vuej, dhe ne vuejtje vdes.
Po unë, kur? heu! kur kam për t'u qesh?
Apo ndoshta duhet ma pare te vdes?

O, si nuk kam një grusht te fuqishem!
Malit, qe hesht, mu ne zemër me ia njesh!
Ta shoh si dridhet nga grusht' i paligjshem...
E unë te kënaqem, te kënaqem tu' u qesh.

Kanget e Pakendueme

Thelle ne veten teme flejne kanget e pakendueme
te cilat ende vuejtja as gezimi s'i nxori,
te cilat flejne e presin një ditë ma te lumnueme
me shperthye, m'u kendue pa frige e pa zori.

Thellte ne veten teme kanget e mia jesin...
e unë jam vullkani qe fle i fashitun,
por kur t'i vijë dita të gjitha ka me i qitun
ne një mijë ngjyra te bukra qe nuk vdesin.

Por a do të vijë dita kanget me u zgjue?
Apo ndoshta shekujt me ne prap po tallen?
Jo! Jo! Se liria filloi me lulzue
dhe e ndjej nga Dielli valen.

O kanget qe fleni reliktet e mia
q'ende s'keni prekun as një zemër te huej,
vetëm unë me ju po kënaqem si femia
unë djepi juej; ndoshta vorri juej.

Vuejtja

Ka do dit
qe po shoh fare mirë
se si nga vuejtja syt po me madhohen,
nëpër ball dhe ftyre rrudhat po me shtohen
e si buzqeshja m'është e hidhun...
... dhe po ndij
se si mengjeset e mia
nuk janë ma mengjese hovi e pune,
as ndërtimi, por te shtymt dita me ditë
e një jetë qe s'durohet.
Dalngadale po shoh
si jeta një nga një
secilin ndjesi
me tradhti
po ma vulos
dhe s'po me mbete asgja
qe me u nda
si shej gezimi,
përpara
nuk e dishe, ojete,
se kaq i tmerrte
është grushti i yt
qe mbyt
pa meshire.
Por kot
ne pasqyrë po shoh
se si nga vuejtja syt po me madhohen
nëpër ballë dhe ne ftyre rrudhat po me shtohen,
dhe shpejt do të bahem
flamur i vjetruem

i rreckuem
nderluftat e jetës.

Të lindet njeriu

Të lindet një njeri
nga gjin' i dheut tonë te rim me lot te vaket,
nga thalb' i shpirtit tonë qe shkrihet ne dëshirë te flaket
për një gen të ri,
Të lindet një njeri!
Pa hyll ne ball por qe me fjale te pushton,
qe te rremben qetsin e ban gjakun te te vloje rrkaje,
e ban synin ligshtin ta zhgjetoje,
qe nëpër shekuj ndërgjegjen na tradhton.
Të dali një njeri!
Të mkambi një Kohe te Re!
Të krijoje një Epope!
Nder lahuta tona te këndohet Jeta e Re...
Të gjithë kombet po dehen n'epopea te veta,
flakë e zjarrmit te tyne na i perzhiti ftyrat
dhe nëpër to një nga një po shtohen rrudhat,
e nën kambe e mbi krye tinze po na ikjeta.
(Liri! - Po, liri dhe gaforrja gezon,
por gaforre është...
Liri, ku plogsi ndërgjegje gjallon,
jo, liri nuk është!),
Të lindet një njeri
i madh si madhni
dhe ndergjegjet tona t'i ndezi ne dashni
për një ide te re, ideal bujar,
për një agim te lum e te drejtë kombtar.

Balade Qytetese

Mbrame
qiella dhe hyjt e vrame
një ngjarje te trishtueme pane:
Hije... jo! por një grue
me ftyre te zbete edhe me sy
te zez si jeta e saj,
me buzen te vyshkuna ne vaj,
me plage ne gjoks e stolisun
me veshje dhe me shpirt te grisun,
me hije grueje,
një kens këso botë,
një fantom ujë
vallzonte valle ne rrugë te madhe.
Dy hapa para, dy hapa mbrapa
me kambe te zbathun,
me zemër te plasun.
Dy hapa djathtas, dy hapa majtas,
me floke te thime,
me ndjesi te ngrime.
(Dikur,
kur gjit' e saj me kreni
shpertheheshin n'arome,
kur ish e njome
atëherë e dashunojshin shum zotni.
E sot?)
Jeta e saj është kjo vall' e cmendun
ne rrugat e qytetit tonë,
një jetën e fikun, një jetë e shterun,
shpin i molisun, zemër e therun,
një za vorri, një jehone

qe vallzon naten vonë
nëpër rrugat e qyteti tonë.

Lagja e Varfun

Krahet e zez te një nate pa fund
e varrosen lagjen pranë,
drite, jetë, gjallsi askund,
vetëm errsine e skam.

U harrue jeta e ditës
nder shtresat e nates, e pagja
u derdh nga parzm' e errsines...
n'andrra perkundet lagja.

Njerzit nder shtëpia flejne
me gjoksa te lakurte e te thate
e gratë... femi po u lejne
pa ushqim ne gji, pa fat,

Pushojne gjymtyrt e shkallmueme
ne punën e ditës se kalueme,
sherohen trute e helmueme
ne gjumin e nates s'adhrueme.

Veç zemrat e njerzve te lanun
me te rektunt prralla rrfejne:
mbi barrat e jetës se namun
qe shpirt dhe korriz thejne.

Prralla mbi femij rrugaca
barkjashte e me hunde te ndyta,
qe dorë shtrijne me vjedhe, me lype
e ngihen me fjale te ndyta.

Prralla mbi varza te fyeme

me faqe e me buzë te thithna.
Prralla mbi djelm, me te thyeme
shprese, ne burg me duer te lidhna,

te cilt nesër para gjyqit
për delikt do të pergjegjin,
vetëm dreqit e hyllit
te gjith fajet tash ua mbshtesin.

Kështu lagj' e varfun peshprite
dhe errsines hallet tregon.
Një gjel i undshem, me drite
te hanes i rrejtun, këndon.

Hesht! or gjel kryengritës,
i lagjes se varfun. Këtu
nuk zbardh për ty drita e drites.
i gjikuem je me ngordhe n'u.

Blasfemi

Notojne xhamiat dhe kishat nëpër kujtime tona,
e lutjet pa kuptim e shije përplasen për muret e tyne
dhe nga këto lutje zemra zotit ende s'iu thye,
por vazhdoi te rrahi nder lodra dhe kumbona.

Xhamiat dhe kishat madhshtore nder vende te mjerueme...
Kumbonaret dhe minaret e nalta mbi shtëpia tona perdhecke...
Zani i hoxhes dhe i priftit ne një kange te degjenerueme...
O pikture ideale, e vjetër një mijë vjeçe!

Notojne xhamiat dhe kishat nëpër kujtime te fetarve.
Tingujt e kumbones ngatrrohen me zanin e kasnecit,
Shkelqen shejtnia mbi zhguna dhe nder mjekra te hoxhallarve
O, sa engjuj te bukur përpara deres se ferrit!

Mbi keshtjellat mijvjecare qendrojne sorrat e smueme,
krahet i kanë vare pa shprese simbojt e shpresave te humbune
me klithma te deshprueme bajne fjale mbi jetë te pemdueme,
kur keshtjellat mijvjecare si xhixha shkelqejshin te lumtuna.

Melodi e Keputun

Melodi e keputun
lot i kjarte nga syni
i një grues se dashun...
andje e perplasun,
xhevahir i tretun,
një anderr e shkelun,
buzë e paputhun
ne melodin e keputun.
Nga vaji i heshtun
shkunden supat e zhveshun,
verbojne nga zbardhimi...
e ther, ther hidhnimi
për casteet e rreshqitun,
për fatin e ikun,
për gezimin e humbun
ne melodin e keputun.
Brrylat nder gjuje te mpshtetun,
ftyre ne shplake e fundosun:
Qan grueja e pikllueme
me zemër te piskueme
(një kitare e gjymtun,
za kange i mbytun
ne buzë nga dhimb' e puthun
ne melodin e keputun).
Hesht njeriu pran grues
qe qan e turpnueme...
syni i venitet
ne te loti vervitet,
diçka nxjerr nga xhepi
grues ia le dhe se shpejti
e len gruen e humbun

ne melodin e keputun.
Por kur vjen ndoj tjetër,
epshi kaperthehet,
gjaqet turbullohen,
përzihen, pervlohen,
cohen peshe, terbohen
... e vetëm ndegjohen
ahtet e molisun
ne melodin e grisun.

Kanga e te Burgosunit

Neper hekra te kryqzuem te dritores seme
shoh qiellen te coptueme ne katerdhete cope
edhe shoh diellin sa një pare serme
aq larg është qielli nga e emja grope.

E kjo grope e eme e ka emrin burg.
E dini se burgu nuk është për defrim.
Prandaj burg' i em është shum i ulte
dhe me bani palmuc dhe me mbyti ne trishtim.

Hekrat e kryqzuem dhe ndergjegj' e eme,
dy anmiq te betuem, luftojne dit' e nate;
por hekr' i fortë e mund ndërgjegjen teme
dhe ne deshprim përplasem si një qen i ngrate.

E kur nata vjen dhe xhixhillojne hyjt
gezohem fort, se hekrat nuk m'i kryqzojne syt',
por t'u sjellmen mbrapa shoh dritën e smute
edhe hijen teme tu' u zgjate ne murt

si një kercnim ligji, posi një dajak.
Dhe atëherë terbohem dhe urrej pa masë
dritën, hijen, veten, muret edhe hekrat
edhe e ndjej veten lua te ndryem ne kafas.

Neper hekra te kryqzuem te dritores seme
shoh qiellen te coptueme ne katerdhete cope
dhe zemra e eme ndien po aq te breme
ne mes te katër murve si ne një grope.

Kanga e dhimbes krenare

O dhimbe krenare e shpirtit qe vuen
dhe shpërthen nder vargjet e lira...
A deshte, vall, për t'u ngushlluem
tu' e stolise botën me xhevahira?

O dhimbe krenare nder vargjet e lira,
qe kumbojne me tinguj te sinqertë...
Vall, a do të prekish kend nder ndijesina?
Apo do vdesish si vdes gjethi ne vjeshte?

O kange e deje e dhimbes krenare...
Mos pusho kurr! Por bashke me vaje,
si dy binjake kendoni mjerimin
se koha do t'ju bije ngushllimin

Vjeshta ne Parakalim

Vjeshte ne natyre dhe vjeshte nder ftyra tona,
Afshon ere e mekun, lengon i zymte dielli,
lengon shpirt' i smum nder krahnore tona,
dridhet jet' e vyshkun nder gemba te një plepi.

Ngjyret e verdha lozin ne vallen e fundme
(dëshirë e marrë e gjethve qe një nga një vdesin!)
Gezimet, andjet tona, dëshirat e fundme
nëpër balta te vjeshtes një nga një po shkelin.

Një lis pasqyrohet ne lotin e qiellit,
tundet dhe pergjaket ne pasion te viganit:
"Jete! Jete unë due!" - e fryme merr prej fellit,
si stuhi shkyn ajrin... por në fund ia nis vajit.

Dhe m'at vaj bashkohet horizont' i mbytun
ne mjegull perpise. Pemet deget e lagun
me vaj i mshtjellin ne lutje por kot! e dinë, te fikun,
se nesër do vdesin... Vall! A ka shpëtim ndokund?!

Mallengjehet syni, mallengjehet zemra
n'orën e vorreses, kur heshtin damaret,
e vorri inaltohet nën qiella ma t'epra
me klithem deshprimi qe ne dhimbe te madhe zvarret.

Vjeshte ne natyre dhe vjeshte nder ftyra tona.
Renkoni dëshirat femite e jetës se vafun;
renkoni ne zije, qani mbi kufoma,
qe stolisin vjeshten nëpër gemba te thamun.

KANGA E PËRNDIMIT

Kangë Pëmdimi, kangë njeriu të dehun nga besimi në vete
Kanga e tij një fe tjetër, me tempuj të tjerë, me meshë solemne,
ku prej mëngjesit deri në mbramje shkrihen ndjesitë tmtë njerzore
n'apoteozën e hekurit; shpirtënt përshkohen në tymore,

të cilat në fishkllim i përqeshen zotit të vjetër edhe qiellit
e me re të ndyt' tymi të dendun ndriçimin ia vrasin diellit.
Fe tjetër, fe e çmendun e Pëmdimit të mrekullueshëm...
1 ekzaltuem shklet njeriu në delirium të pakuptueshëm.

Dëgjon zanin q'i thotë feja. Plagos qiellën, e shpon tokën,
i shkyn horizontet e bardhë, zhvesh natyrën - ia heq kotllën.
Kult' i tij - kult i zhveshun! Nuk ia bren ma trutë enigmi -
e varros, mbi varr ia vë një shej përbuzje o nderimi.

Kangë Pëmdimi, kangë njeriu të dehun nga besimi në vete
Kanga e tij shpres' e bukur, me flatra të një tjetërjete
në të cilën dielli do ndrrojë udhën: ka për t'u lindë nga Pëmdimi
- por deh! nga lumnia tash humb kokën rruzullimi.

Me një "tango" qejfi tash ia ngatrron fijet zotit të vjetër
ka me ia skandalizue të birtë besnikë në planetë të tjeter,
Kanga Pëmdimi, kangë njeriu të dehun nga besimi në vete...
Le të dëgjojmë kangën që mshtillet në shllung' avulli në pika djerse.

Shpirtent shtegtare

Mbrame një ere e ftohte acar fryni nga ana e maleve,
i shkundi shpirtent tonë bashke me gjethe te kësaj vjeshte
i mori andej kah dielli hijen si te pergjaket ua lëshon zalleve
ne Perndim, ku shtret e shkimet dita ne pamundsine e vet
Enden shpirtent tonë nëpër vise te Perdimit te mrekullueshem,
bajne te fala dhe me thanë vendeve te shuguruem
e te peritnme nder fluide te hekunt te zjarrmit adhurueshem
e me një kredo gezojne qiellen me cagje e te tymuem
ne cilën, diku ne skaj merimanga fatin tregon
vetes dhe njerzis poshtë, qe damaret i rrahin
(si te rrahunt trompete ne vorreze) ndërsa tue qa, kumbon
e thrret kumbon' e fabnikes, i njemijti fishkellim si një fsham
shkyn ajrin
Shpirtent tonë me një dashni tragjike ato vise i duejne.
n'eter te kulluet u bajne fli ndjenjat e veta ma te holla
E te nesërmen fatale kundrojme një horizont me njolla
shtegtare te merguem. shpirtent tonë n'origjinë po kthejnë

Ekstaza Pranverore

..dhe pranvera erdhi...
Neper ftyra tona rreshqiti nji gezim
dhe nder zemra tona ngrehi një fole,
e një jetë e bukur, e një jetë e re,
me dëshira te shumta po buzqesh ne lulzim.
...dhe dallndysha erdhi...
si shpirti n'ekstaze, ne hovin e shejt shtri;
me qiellen rroket, me diellin puthet,
dridhen krahet ne hare mandej poshtë versulet
t'u dhurue ne cicrim pershndetje një mijë.
...triumfon bylbyli...
kangetar plot magji ne gemb te trandafiles,
ne një tempo te marrë perkdheljet po shfre
e kënga kumbuese, kang' e tij pa fre,
është si kange Orfeji nder telat e lyres.
...dhe vesa shkelqen...
ne një pikë t'argjant pasqyrohet jeta
terheqse si andrra dhe si vijzatimi
nder orët e hyjzimit, kur shpërthen agimi
e rrezet e arta rreshqasin nder fleta.
... dhe pranvera erdhi...
Neper ftyra tona rreshqiti një gezim
dhe nder zemra tona ngrehi një fole
e një jetë e bukur, e një jetë e re
me dëshira te shumta po buzqesh ne lulzim.

Dy Buze

Dy buzë te kuqe,
dy dëshira te flakta,
qe afshin ma thithen,
gezimin ma fiken,
si fantazma iken
nder do bota te larta...
Dy buzë te pergjakta,
dy dëshira te flakta,
qe afshin ma thithen
ne buzë kur m'u njiten
andjet m'i trazuen,
zemren ma terbuen,
trunin ma helmuen
e në fund u merguen...
Dy buzë te kuqe,
bukuri fatale,
te një grueje sterzane
një pranvere te tanë me morme
një pjesë zemre me nxorme,
dhe gezimin ma vodhne...
Ato dy buzë te kuqe
dhe dy lote te mia
qenë shenjat e dhimbjes
kur me vrau bukuria,
kur me zu dashunia
e me dogji rinia.

Sonet Pranveruer

Me kange ne buzë e me hove të reja
u zgjue agimi pranveruer,
largesinat e hjedhta ka zatete hareja,
n'argjent shkelqejne brigjet terthuer.

Me kange ne buzë u zgjue agimi
dhe ia kendoi këngën diellit t' art
rrezash purpure dhe jetedhurimi
me kaltrinat e thellta ne qielle te kjarte.

Me manushaqe ne buzë e me andje ne zemra
vajzat si biluri nder kopshtie te gjelbra
dihasin aromat, qe lulzimi derdhi,

me gji te paprekun, ku dashnia sose
me fletza trandafilesh qe flladi sjelli
dhe adhrojne pranveren me një apoteoze.

Z.B.

Buzmramja u dridhte nder afshet e mbrame
te diellit perndimuer
me kuqlim e tisa purpuer,
me kaltrina te kullueta ne qielle e ne sy tand.
ku në fund u pasqyronte një dashni e lume
si vegimet e fatbardhsis ne lima,
mbi te cilin terthuer fluturon një pellumb
dhe gezime te pamatna gugon pa pra.
Zojushe, q'at buzmramje
unë andrroj me andje
dhe me një dashni te pastër
ata dy sy tuej te kalter,
qe m'u falne lete
me një shikim diskret.

Ndeshja

O grue, qe te ndesha ne ditn e fatkobit tem,
kur prirja njellte e syt shikojshin zi
e ndjejshe veten se dhe unë jam fli
te një ndjesi si ti.

O grue, q'u ndeshme ditne e fatkobit tonë
zemër për zemër edhe ball për ball
e ndjesite n'u shprehen me mall
me një vall':sahall...

Dhe kështu ne rrugë te madhe e shitme zemren tonë,
njerzve qe vetëm një te perqeshun dhanë për te
e shkuen te kenaqun e tu' u gezue pse
pane mfshehsinat intime te kësaj jetesës sone.

E na, dhe një dhimbe te sinqertë tue ndije,
vuejshim me zemër te ndrydhun si dy fëmijë
te humbun nder vise te hueja naten, vonë,
o grue, q'u ndeshme ne ditn e fatkobit tonë.

Një nate

Grue a hyjneshe, e mbeshtjellun n'errsi te nates,
zbriti nga sfera te panjoftuna nder odat e mia
dhe u shtrue një fllad, një e kandshme ndjesi,
një heshtje parathanse zemren don te ma perpije,
vetëm qe ora këndon këngën e thjeshtë te nates
-jo -jo! dhe diku larg dëgjohen tingujt e kanges
Grue a hyjneshe m'erdhi nga gjin' i errsines...
Qe! frymën ia ndjej dhe zemren qe rreh prej fellsines.
Buzet e njoma te saj,
Syt e zez e te mdhaj
me hamnoni vijash te bindshme
premtojne një dashni te hijshme
(ashtu dhe akordi i heshtjes
frytin e ambel te marrveshtjes).
Dhe njemend! At nate vallzuen ndjesit e jona
me një valle defryese, pa marrun fryme...

Mbas Tryezes

Kështu ne te rinjve na kalon nata:
Prane tryezes meremer-falso, me gote te plotë a boshe,
me kujdes të madh ndejun (si e lyp dans-edukata),
te ngrehun, te ngrime, te stolisun
e ftyrash te qindisun
me puder, karmin... jo? por me përshtypje te mirë
qe na e sjell zojusha e bukur dhe me hirë
tu' na buzqeshe ambel, buzesh te kuqe si gjaku,
nsa gjit' i majen, dridhen ftyra kuqet, zbehet...
e ne secilin prej nesh në fund ka një shprese kendedhet
dhe na shtrengon laku...
Qashtu ndeje, tu' e vrejtun, ÃƒÆ'§ojme biseda të ndryshme
serioze, t'urta, por ma shpesh te dyshueshme,
me gjuhe te bukur, te zgjedhun, mbi ngjarje te ra flasim
e prej një deshires pa mshire te gjithë pelsasim.
Ngushllim! se zonjusha na i din mirë hallet,
prandej aq me andje, bukur, kercen vallet.
Tonet muzikore derdhen, rrkaj derdhen,
lemojne ata qe ne valle sjellen, ne hare sjellen,
lemojne tryezen, gotat, veshjet tona, ndjenjat
e fantazis sone, i hapen ylber velat...
Por befas, te njejones se panjoftun tingllimi,
se cilës është te hyu i bukuris trillimi,
krahnoret n'i perkdheli dhe n'i piskoi zemrat,
gjatë korrizit te thenet zbresin fill te themr;
Qashtu vuejme, defrejme...
Jeten adhurojme,
nsa drita shkelqejne
zojushen shikojme
dhe n'andrrim vallzojme...
Rishtas, me plot dashje, vallet ndiqen, ndiqen

Vash e djalë përputhen
mbrend dy zemra digjen,
por me u puthe nuk puthen!

Hidhet e përhidhet

Hidhet e perhidhet ne shtregullen e fatit
djalosh' i Arbenis.
Hidhet e perhidhet ne pemdim mbrapa malit
me hovin e rinis
zogu i liris!
Ne shtregullen e fatit, nder këto fluturime
ma shpejt i rreh zemra edhe merr drithtime
se qiellat e hueja premtojne gezime t'ambla
nëpër shkalla te hueja, nën te ngjyrta llamba
premtojne hyjnizimin ne vallen e defrimit;
femen-mashkull rrokun si dy vete qe mbyten
kin për te mbramen here qindenje here puthen
e mbrenda krahnorit gati te pelsase zemra,
nsa majet e kepucve shkarravisin germa
te tanë naten e lume deri ne te lem t'agimit.
Për njenin ky gezim, për tjetrin gezim tjetër...
ndoshta vllime librash, atom ose kompas
fund' i fundit shkundet ai djalosh i vjetër
nga melankolia fillon te vueje pa masë.
Dh' atëherë nalmadhnia e tij mbret Dyshimi
futet ne zemër, ne tru, ne jetën e te riut
mfshehtas fillon lojen tinzake, si krymbi
ne thalbin e molles... e syni i te riut
merr hijen e vendit, hijen e një murit
mbrapa te cilit rrahin zemrat e makinat
m'i krijue jetë te tjetër, njeriun e gurit...
... po, një ringjallje mbi te vjetra kalbsinat.
Syn' i te riut muer hijen e atij murit.
Hidhet e perhidhet
zogu i liris,
por dhe bjen ku lidhet djalosh' i Arbenis.

Malli rinuer

Valet muzikore fluturojne nga perndimi
shkrepen e pertrihen
për muret e dhomes seme,
edhe mandej dridhen
mbrenda ne zemren teme
dhe zgjojne ndijesina qe mblue ka hini.
Ndijesite e mia me valet muzikore
shkembejne puthje te nxehta
posi dy dashnore
e pa mshire shegjeta
me ther ne krahnor
edhe më merr malli për jetë ma gazmore.
Malli rinuer për jetë ma shkumbuese
flen pa fat ne mue,
një tingull pemdimi
është ngushllim për mue
kur me mshtjell mashtrimi
me melankoline e vet aq trishtuese.
Tingujt miqedashes, qe ne dhomen teme
me falin rytmin
e një dansit te largët,
me kujtojnë perqafimin
e ciftave te shkathet
qe sjellen hirshem nëpër drrasa te gedhenme.

Një nate pa gjume

Pak drite! Pak drite! Pak drite, o shok, o vlla.
Të lutem, pak drite ne ket nate kur shpirti vuen,
kur te dhemb e s'di c'te dhemb, e syni gjum nuk ka,
urren nuk din c'urren, don e s'din se c'don.
Pak drite! 0 burrë! 0 hero' ngado qe të jesh. ....
Burre qe shkatrron edhe qe nderton sërish!
Pak drite vetëm, te lutem, mshire të kesh,
se do cmendem ne ket nate pa gjume dhe pa pishe.
Oh! ta kisha pishen te madhe edhe te ndezun!
Me flaken e pishes ne qiellin e ksaj nate
ta shkruejshe kushtrimin... Ehu Burre i tretun
Do ta shifsha vallen tande ne maje te një shpate.
Por pishe nuk kam e vetëm janë burrat, shoket...
Dergjem n'errsin pa gjume dhe pa drite...
Askush s'me ndigjon, cirren kot me kot...
Hesht more, hesht! por qëndro, o shpirt.
Gjeli këndon dhe thotë se është afër drita
Gjel, rren a s'rren? cila është fjala e jote?
Kur ti këndon thonë se është afër drita...
Por un s'besoj sonte ne fjalët e ksaj botë.
Hiqmuni qafe, mendimet
O jastek ty te rroki, te perqafoj si shpetimin,
me fal atë qe due: gjumin dhe andr'min
e dy buzve qe peshperisin ngushllimin.

Frymezim i pafat

Frymzim' i em i pafat,
qe vjen e me djeg mu ne gji,
për ke po më flet? për ke te shkruej?
përse po me ban qe kaq te vuej?
pse vjen e me djeg mu ne gji,
frymzim' i em i pafat?

Për te gjoret? për ata qe nuk kanë drite?
O frymzim' i em i ngrate,
mjaft me plage qe s'kan sherim,
leni te dergjen ne mjerim,
Njerzit s'duen ma trishtim,
botës s'ia kande atë kange te thate,
thot se mjell një fare te idhte.

Far' e idhte... far' e idhe...
O njerz te bime nga far' e ambel!
Frige të mos keni, pse një kange
mund t'ju theri ne ndjesi,
t'ju kujtojnë zemren ne gji
ne ndërgjegje dhe një dange...
por ju t'ju baje edhe ma zi.

Frymzim' i em i pafat!
Shporru ktej! Nuk te due!
S'i due hovet tueja te nalta,
as fluturimet... Neper balta...
te ditve tona te shklas un tue
rroke me njerzit qe rrok nata.

Vetmija

Me plak merzitja
qe vetmia me sjell;
perbuzja, urrejtja
te gjith sendet m'i mbeshtjell
qe kam shumë anmiq
te liq
ne këto sende pa shpirt,
Nuk flasin.
As sy s'kanë.
Po mue me bahet
se aty janë
vetëm qe te me plasin
zemren.
Se paku, te me shajne:
I mallkuem!
Se paku, te anë tallin:
I uruem!
Se paku, te me kendojne:
I yni zot!
Ose te me thonë:
Jeton kot!
Të flasin, te flasin se fjale due
ne ket vetmi me ndigjue.
Ose te me tregojnë historinë
e tyne, autobiografine:
ndoshta ty do gjej gjasim
me jetën time pa tingllim
qe ne vetmi po e kaloj
dhe s'po dij a rroj e s'rroj.
Sendet heshtin. sa te pameshire!
Me bajne dhe mue te hesht me pahire,

pse goje s'kanë
dhe nuk flasin,
aty janë
vetëm te me plasin
zemren teme qe po vuen
dhe ne merzi vetveten truen.

Shkendija

Nga zjarrmi i votres u shkeput një shkendi
dhe nëpër oxhak, u versul ne liri,
nëpër mes t'errsines
muer udhën e qielles
dhe ne mes hyjve te nates
zu vendin e Hanes.
Ndrit shkendi e gjallë ne qiell plot me hyjë,
ndrit shpirti i ri, lidhe me t'arta nyje
nyjet e dashnis,
dashni e feminis
për te mjeruemet ne botë
qe vuejne, derdhin lote.

Sa bukur shkendija xhixhillon n'errsine,
vallzon bashke me hyjë dhe andrron lumnine...
e poshtë votra fiket,
pranë saj zemra liget,
zemra e një plaku,
i cili del te praku

dh'e ngreh shkopin ne hyjë shkendin për me gjete,
rebelin, qe votren e shtepise e la te shkrete...

O ti femi i ri!
E zjarrta shkendi!
Pse votren e le?
Me thuaj, pse? Pse?

E shkendija, hyjet, te tanë qiella arbnore
ne nett e argjenta, të reja - posi hark kunore
zbret mbi shtëpia tona...

e na gzohna, gzohna...
dhe puthim agimin...
- qashtu rrfejme gezimin.

Rezignata

Na shprehun te ngushlluem gjetme ne vaj...
Mjerimet i morme ne paje
me jete... se kjo bote mbare
nder gji t'Univerzumit asht nje varre,
ku qenia e denueme shkrrahet rrshane
me vullnet te ndrydhun ne grusht te nje vigani.
-- Nje sy i stolisun me lot te kulluet se dhimbes se thelle
ndrit nga skaji i mjerimit,
e kaihere nje refleks i nje mendimit te hjedhte
veton rreth rruzullimit
shfrimin me gjete mnis se vet te mnerte...
Por kreu varet, syn'i trishtuem, mbyllet
e nga qerpiku nje lot i kjart' shtyhet
rrokulliste nga ftyra, bie ne toke e thrrimet,
e nder thrrimet e vogla te lotit ka nje njeri lindet.
Secili prej tyne n'udhe te fatit te vet niset
me shprese ne ngadhnim ma te vogel, pershkon
te gjitha viset
kah rruget jane te shtrueme me ferra e rreth
te cilave shifen
vorret te shpelame me lote e te marret qe zgerdhihen.

Shpirt i ri

Shqiponje me krahe te thyem! Vall, shpirti i plagosun!
Shpirt! aht i kulluet! dhimbe gjoksi te brengosun!
Vall, shpirti i therun... fli e nje lterit te ri,
vaj' i nje skamnori, te vllaut qe heq zi.

Shqiponje me krah te thyem! Vall, shpirt i molisun!
Qendro! Qendro krenar! mu si nje zot i stolisun
me diell t'arte ne ball, me qiella t'azurta ne sy...
Qendro! si vaj skamnori -- ende ka fryme ne ty.

O shpirt! Pellumb i gjore! Lajm i idealit te ri...
Zhgule shegjeten nga vetja, e rishtas, me dhimsuni
flutro mbi valet e jetes e fjale ngushllimi peshprit,
shero plaget skamnoreve e shpresen ne jete ua rrit.

Por hesht, shpirt'i goditun, fellte hesht ne pikllim,
i dhimset vetja shpirtit...o vall, se c'idhnim!
Shikon boten skamnore, plagen shikon me sy
e lote xhevahiri derdh...o vall, u fik nje hy!

Rima e tretun

Jeta i kaloi si nje gote shampanje.

Nett i coi ner shtreten mbi gji te grave,
te cilat e deshten fort a ma fort per pare
sesa per kafshimin e tij te dhambve.

Dhe syparja ra...
Protagonisti vdiq...

Kanga skandaloze

Një murgeshë e zbetë, që bashkë me mkatet e botës
bar dhe mkatet e mia mbi supet e vet të molisun,
mbi supat e verdhë si dylli që i ka puth hyjnia
- kaloi rrugës së qytetit si ejll i arratisun…
Një murgeshë e zbetë, e ftohtë si rrasa e vorrit,
me sy boj hini si hini i epsheve të djegna të gjallesës,
me buzë të holla të kuqe, dy gajtana
pshertimet që mbysin
ma la der' vonë kujtimin, kujtimin e ftohtë të kalesës.
Prej lutjesh (jo tallse!) duel dhe në lutje prap po shkon…
Lutjet i flejnë gjithkund: ndër sy, ndër buzë, ndër Gishta.
Pa lutjet e saj bota, kushedi, ç'fat do kishte?
Por dhe nga lutjet e saj ende s'i zbardhi drita.
O murgeshë e zbetë, që çon dashni me shënjt,
që n'ekstazë para tyne digjesh si qiriu pranë lterit
dhe ua zbulon veten… Smirë ua kam shejtënvet:
Mos u lut për mue, se due pash më pash t'i bij ferrit.
Unë dhe ti, murgesh, dy skaje po të një litari;
të cilin dy tabore ia ngrehin njeni-tjetrit -
lufta asht e ashpër dhe kushedi ku do t'dali,
prandaj ngrehet litari edhe përplasen njerzit.

Kanga që S'kuptohet

U vodh kanga nga zemra e kombit,
shpërtheu në vaj të dikuem mjerimit,
këndoi ujen e së bijës, këndoi ujen e të birit,
qau jetën e thyeme nga rrufe e fatit,
i mbyti në lotë shpirtënt që ndjejnë dhimbë për të ngratit.

Kangë a vaj? Çë je? Thuejma, zemër kombi!
Zemër që ke vuejtun, që ende po vuen...
Kangë a vaj? Çë je? Çë në ty po vluen?
Mallkimi ndaj fatet që ditët t'i helmuen,
që dëshirat e jetës të gjitha t'i gozhduen?

Oh, jo! Kanga jote asht shprehje e dhimbsun
e njëjetese që dergjet e dergjet
dhe tu' e dergjë ndoshta do hesht e molisun...

Motivet

A nder kujtime te shkimuna asht motiv' i nje vjershe?
nder kujtime te bardha te feminis virgjine,
kur zemerplote me mbare boten defreheshe
ne deshire, shpresa e t'ambla andrrime?

A nder kujtime t'aferme te djaleris vullnuese
asht motiv' i zjarrte i nje vjershe dashunie,
me rime tingllueme e shprehje flakruese
plot lumni jetese dhe gezim brohorie?

Nder ftyra te zbeta te grave te mjerueme,
qe enden dhe neper pragje, tu' u shitun lypin,
nder ftyra u shkarravitet nje vjersh' e permallueme
me vaj, me ankime qe der ne qiell hypin;

neper skaje t'errta, ku shungllon zgerdhia
me neveri, ne te cilen tregohet i marri,
te cilin ndjek e shoqja, i biri dhe e bija
-- ne revolt aty krijohet moto-permendari,

neper skaje te mshefta ku droja ka mrizin
e qetsia shtrohet tue perpimun jeten --
aty bashke me tradhti motivi ze fillin
e pena e poetit me te zhvillon vjershen.

Gjate jeteses se njeriut motivet te gjitha ngjyrash
shkojne e vijne pa pramun. Po erdh motiv' i mbrame,
i tmerrte ne fantazi tone - atbote nje te zbem ftyrash,
nje hij' e keqe -- dhe kumona dam - daaam.

"Trajtat e Mbinjeriut"

Dityramb Nietzche-an

Nje vegim shpirtnuer n'errsin te paskajshme
ne boten e mjerimit,
nje rreze e diellit
me ngrof zemren e ngrime te kesaj botes se varfshme.

Shpejt zhduken pranverat, posi shkumbe e detit
dhe shembet hareja,
e stinat e vjetra
pa ngjyra, pa trajta, mjellin fara helmit.

Nana - dhe vejushe dhe me gjithe shitue
na pjell fryte t'egra,
na pjell hithra, ferra
- s'u gjet burr' i dej andjet me ia zgjue.

Kot e kane sot njerzit, dhe me kot dikojne djersen...
Sa qesharak' mbesin,
sa qesharak' vdesin
nder ethe mundimi per me shijue jeten!

Afrojne buzet te gota, dojne nje hurm te vetem...
por pah! bie ne toke gota,
thehet ne nje mije copa
shuhet drit' e synit, vdesin njerzit t'etshem.

Shpirt i kryqzuem, marrzi e vulosun
asht kjo jete njeriu...
("Zgerdhiu, zgerdhiu

deri ne kupe te qielles, ironi e poshtun!)

Por... po! po! por diç po due me thanun,
ndoshta ka me ardhun...
ndoshta ka me zbardhun...
nje agim i pritun, dit' e parathamun.

N'ardhmeni te trashgueme Mbinjeriu vrehet,
ndergjegje pa dyshime,
ndergjegje pa trillime,
me nje grusht graniti qe kurr nuk do thehet.

Nje sfinks i madhnueshem Mbinjeriu i ardhshem,
pa zemer, pa ndjenja,
syt e tij rrufena -
qarkullojne rreth rruzllit tue synue vranshem.

Kohnat e kalueme ne balle te Mbinjeriut
jane gjurma luftimi,
jane shenja hidhnimi
- se jete e re lindet me vdekje te njeriut.

Marshi i Djalerise

Urdheroj i Madhi Zot:
Zu ndrin yll` i Shqiperise;
Ndrin e me s`permbahet dot,
Se qe sot e jete-plot
Po rreth zemr` e Djalerise.
Djaleri,lart per liri!
Lart per Zonjen Shqipetare!
Yll ne balle-e zjarr ne gji,
Zjarr ne gji per Shqiperi,
Digj-u! zemra djaloshare!
Qjell me shkaba shqipetar!
Male mbushur me dragona!
Keto fusha derdhur n`ar,
deti plot margaritar -
Keto jane viset t`ona!
Ketu leu qe ne fillim
Trim`i dheut si zog i shkruar
Leu dh`u la per trashegim
- Me nderim e me qendrim -
Besa jon` e shenteruar.
Ha! dh`e bukura liri
Ketu mbreteroj perjete:
Mbreteroj: e plot meri,
Beri ne rezik te zi
Prej kujtdo nje trim me flete.
Lithni besen per Atdhe,
Ju me gjak te Kastriotit!
Lithni-e shpejt e beni be:
Be qe vret posi rrufe
Para Kombit - para Zotit!
Djaleri,heu! yll i ri!

Djaleri,keng`e shendetit!
Per liri,per lumteri,
Rrofsh! e lumja Djaleri!
Rrofsh e qofsh sa val`e detit!

Parathania e Parathanieve

Perdite perndojne zotat
dhe rreshqasin trajtat e tyne
mbi vjet dhe shekuj
dhe tash s'po dihet ma kush asht zot e kush njeri.
Nder tru te njerezimit zoti galuc ka ndejun.
Vetvetes me gisht tamthat i ka biruemun
ne shej te pendimit
dhe bertete ne kulm te hidhnimit:
cka, cka krijove?
-- Njeriu nuk e di:
a asht zoti pjella e tij,
apo ai vete pjella e zotit.
Por e sheh se asht kot i kotit
me mendue mbi nje idhull
qe nuk pergjegj.
Dhe tash s'po dihet ma kush asht zot e kush njeri.
Ka ardhe nje kohe,
ne te cilen njerezit po kuptohen fare mire
per me ndertue Kullen e Babilonit, --
dhe ne maje te Kulles, ne maje se fronit
ka me hype njeriu
dhe ka me thirre:
Perendi! Ku je?

"Kange ne Vete"

Veri fryn pa mshire, si veri qe fryn,
dhe si hajn ne shtepiat e kojshive hyn -
edhe per çudi
keta kojshit e mi
sa mire e presin... megjithese nuk asht dite vere
ato ne gjuhe te huej i thone: mire se erdhe!

Veri fryn dhe me acarim u premton pallate te kristalta
kojshive te mi qe ua kande shume andrrat e thata -
dhe u thote keshtu:
stergjyshnit e ju'
qene fatosa te vertete dhe u bane flija
per fe dhe atdhe dhe i merituen keto premtimet e mia.

Dhe kojshite e mi qe i kam farefis,
nipat e stergjyshnave meleza dhe te lete,
nipa done me mbete,
nipa te vertete
me atdhe e fe nder andrrat e thata
qe t'i meritojne premtimet e kristalta.

Veri fryn pa mshire, si very qe fryn;
Une ia mbylla deren teme me reze mos te hyn
me ma fike ket drite,
me ma ngri ket shpirt,
me ma dridhe per ndjesine tjeter,
me ma joshe me anderr te vjeter.

Fragment marre nga novela "Nje rrefren i qytetit tem"

Prej mshires se pamshirve
lypsi i vogel gjallonte.
Jeten e rrokullonte
neper udha te ndyta
neper skaje t'errta,
neper pragje te ngurta,
nder besime te rrejta.
Por nje dite, kur mshira e diellit e shteri,
ne gjoks ndjeu si e therri
nje dhimbe e re - qe mnia
e perfton nder flia
te skamit.
Dhe - dje lyps i vogel,
por sot diçka tjeter -
si ahmarres i vjetter,
nje fjale te rande mendonte
botes t'ia diktonte...
Fytin e gerdhishte
fjalen per me nxjerrun
qe mnia e kish shterun
dhe qe ne gjuhe vdiste...
Por i hutuem, mbet ndejun
ne kryqzimin e udhve.
Rrotat e autve
shpejt mi te kaluen
dhe e... qetsuen.

(Lorie, kete po kerkoje?)

Luli i vocërr

Askush s'e njef Lulin. As shokët e tij, që përpara tij lozin, nuk e njofin. Ma mire me thanë se e njofin, por ata lozin për hesap të vet e Luli i shikon për hesap te vet. Sot gjithkush ka punet dhe telashet e veta, ashtu dhe fëmijtë, ashtu dhe Luli. More Lul! Shumë heret ke fillue me shikue punën tande!

Kur Luli hyn n'oborr të shkollës, buza i qeshet nga pak, por askuj, asnji fjalë s'i thotë. Ecë ngadale, tue shikue djathtas e majtas, po gjithnji tue ecë deri sa të mbrrijë në cak të vet. Aty, te dera e rruginës shkollore, shumë i pëlqen të qëndrojë. Aty asht caku i tij, i praruem me rrezet e ngrofta të diellit në këto ditët e vjeshtës. Mbështetet Luli për mur, grushtat e vogjël i shtje ndër xhepa, hundën picrroke të kuqun nga të ftoftit e mëngjesit ja sjell diellit dhe...shikon. Gjaja që ma tepër tërhjek vëmendjen janë çizmet që i kanë të veshun disa shokë të tij. Sa te bukura janë! Si shkëlqejnë! - mendon Luli dhe pa dashtje i shkojnë sytë ndër tullumbat e veta, nëpër të cilat shifen fare mirë të pesë gishtat e kambëve të zbathuna. Nga kurreshta i afrohet nji shokut që ka çizmet ma të reja. Ulet dhe shef në lustrin e çizmes kambët e veta të zbathuna - aq shumë shkëlqejshin çizmet!!! Mbasi shoku me çizme fluturoi, Luli ngadalë shkoi te caku i vet, në diell, t'i ngrohi kambët. - Por kur s'ka diell, si ia ban i shkreti Lul? Ndoshta ia bajnë hallin apostujt e mëshirës dhe të dashunis... Noshta, ndoshta...

Nganjiher i afrohet mësuesi Lulit. Dhe kur Luli e ka ftyrën e dlirë dhe pa puça, mësuesi ia ledhaton faqet, gushën, e Luli i afrohet, ja merr dorën, e shikon me sy pëllumbi, dhe kishte me dashtë t'i falë diçka mësuesit. Por vjollca nuk ka. Veç në i faltë tollumbat e veta, që kanë hapun gojën si me dashtë me e hanger mësuesin. Po, po, tollumbat e Lulit të vocërr kanë me e hangër mësuesin.

Buken tone te perditshme falna sot – I

Here verente t'amen se si lutet para kater – pese fugereve, here shikonte neper dritoret ne muzgun e mbramjes. Errsina bahej gjithnje ma e shpeshte, e Lili verente se si drute dhe sendet e tjera marrin trajta te frigshme. Vuri re edhe perjashta t'amen tue u lute nen kandilin e Zojes – i dukej neper qelqe te dritores – dhe argetohej: qe, tamam si kino, po shof kino, sa bukur, aaa! Flaka e kandilit nisi te dridhej dhe Lili nuk shifte ma kino ne qelqe te dritores. Syt i shkuen ne fund t'oborrit: qe, dikush po ec, i gjate, me floke te mdhaja, me shkop ne dore, shikon ne dritore, hajn! Dhe shpejt Lili i friguem dhe nga ftyra e vet ne qelqe u largue nga dritorja dhe iu avit s'ames.

- Nane, dikush asht jasht! …Hajnat, - peshperiti frigshem.

Nana nuk bezante.

Lili e shikonte si lutej neper gjuj, tue levize buzet afer shuplakave te ngjituna.

- Nana e eme nuk asht e fryte si fuçi, si nana e Lecit, mos me mujte me ec, me iu

qeshe gjithkush – mendonte Lili tue shikue t'amen nga profili. Por pse i lot ashtu buzet? Si me thithe sheqerin me buze...sheqerin e hallvaxhis, te kuq, asi si blevi sot Mrika dy per nje çerek lekut.

- Uf, nane, hajt ma, a po çohe, me më dhane me hanger…

E ama permendi ma me za Zot e Zoje, bani kryq dhe u çue.

Shkoi ne dhome te zjarrmit, tue thye gishtat e duerve e tue mendue, mori e shkundi shporten e bukes nga e cila rane disa koje bajate, i mblodhi me kujdes dhe i qiti ne kusi me uje te vluem. Mandej u çue me marre shishen e vojit, por u kujtue se e kish zbraze ne kandil te fugureve.

- Uf, nane, hajt ma nane, - kerkonte Lili me ngrane.

E ama qendroi ne mes t'odes e hutueme, nuk dinte kah t'ia mbaje, thyente gishtat e duerve, krismat e te cilave aq dhimbsunisht tingllojne dhe mendoi diçka.

- Rri ti te zjarrmi, - i that e birit dhe shkoi ne dhome tjeter. Iu avit si hije fugereve, me ftyre te zbeme edhe te frigsueme, pa i shikue fare, i fryni kandilit dhe e fiku. E mori vojin, e derdhi ne kusi dhe nisi ta perzije, nsa buzet makinalisht pershperitshin:

- Qe, moj nane, he, tash po han, - mendimet i kish ngjeti, diku t'arratisuna.

- Merre pak uje dhe fike njat dru, mos te digjet kot, sonte nuk asht ftofte. Grueja u çue, derdhi mbi dru te ndezun uje, i cili bani tym dhe potere, qe rreshpethtas ushtonte ne heshtjen vorreze te dhomes se zjarrmit.
- Cka te tha zotni Filipi? – pyeti frigshem te shoqin, i cili rrinte zymtas ne sy te ngulun mbi hu te fikun.
- Asgja. Cka me më thane…S'ia qet hesapi me më marre. Mundet me e krye me nje njeri at pak pune qe ka.
- Po a kqyre te zotni Lorja?
- Allahile, praj. Mos me pyet. Gjithkund njesoj. Njeni thote s'me duhesh, tjetri s'kam nevoje, i treti nuk po jam tue nxjerre as per vete buken e gojes. Kur ai me gjith ate dugaj…Allahile, mos me pyet, - tha n'idhnim dhe mori mashen ne dore.
- Mire, mire, more Kolë, mos u idhno. Por…Cka kena me ba?
Ai me mashe ne dore shkarravitte nepeper hi te votres dhe nuk i pergjigjej. E ajo matej t'i thoshte mos shkrueje neper hi te votres se nuk vijne, thone se bahen borxhe. Mendja i shkoi te borxhi qe i kane furrtarit, i cili pardje u ka ndalue buken me tefter. i tha Lilit:
- Thueji nanes te çojne paret, po desht me i dhane buke.
- Moj nane! Nuk m'i ke dhane paret…S'ka buke, ka thane, - britte Lili qe nga dera e oborrit.
- Mire, moj nane, s'ka gja. Tash ka me prue baba.
Por baba nuk pruni as buk as gja tjeter, as mbrame as sonte. Rrin prane votres dhe mendon e nje zymtim ia ka ba ftyren si te smundit. Mendon. Eh, sikur te gjitha keto mendime te baheshin pare! Deshte te pyesi per Lilin a ka pas me ngrane gja, por nuk guxoi. Kish frige te mos ndegjoje ate qe s'ka deshire me e dite. Nse s'ka pase çka me ngrane Lili, ma mire mos me e dijte e me genjye veten se ka hanger. Vjedhtas shikonte te shoqen, ne drite te bishtukut i dukej shume e zbete, me sut e thelluem e te nxime perreth. E dinte se c'domethane.
Drita e bishtukut nisi te dridhej, dhe dridheshin te gjitha sendet dhe hijet e vorfna bashke me dy kensa qe dridheshin nga friga e jetes se neserme. Pa buke. Te dridhunit e flakes se bishtukut sikur ua ngatrroi mendimet te dyve. Te dy pernjehere u çuen te shkojne me fjete.
- M'u hiq, pash zotin. Larguhu, - i thoshte e shoqja te shoqit n'errsinen e dhomes, rate, nen fugeret ku kandili nuk ishte ndeze.
- Cudi, pse zoti Filipi me te hjeke nga puna; ty po, e ate dy jo; pse jo njenin nga ata – n'errsin i fliste te shoqit me guxim.

- Ku e di une...E dij se c'mendon ti! Kujton se me ka xane ne ndoj pune te keqe, prandaj me ka qite nga pune.
- Po kot pse po te qet? ...
- A te thashe, moj e marre, se nuk ka pune per tre vete! Ti nuk merr vesh!
- Mire, mire. Mos bertit, se po ma çon djalin.
Heshten. Silleshin e shpervileshin here njeni, here tjetra deri ne nate vone.
Kumbonet lekundeshin, leshojshin tinguj te cilet zvarriseshin neper rrugat e qytetit, lemojshin pullazet e shtepive, futeshin neper vrima, dritore e dyer dhe ftojshin: mos e harroni shtepine e Zotit.
Kola, nga skaji i trotuarit , shikonte ceremonine fetare ne parakalim. Kujtohet se para pesembdhete vjete dhe ai, njashtu si ato femi, barte fugure, qira dhe kendonte kange kishe. Era e kemit(tamjanit) qe i mbrrini te vrimat e hundes i kujtoi ma intimisht feminin shkollore. Si neper reliev shkonte me mendim neper kujtime; nderlikoheshin ftyra shenjtesh, priftnash, mesuesash, shkoesh nder skuta t'errta, tue u lute, dikush me pervujtni e dikush tue shame kujdestarin, qe s'e la me ikun. Eh, sikur te mbetshe ne kuvend, te mos dilshe jashte, - mendonte Kola tue e kujtue gjendjen e vet tashme me hidhnim. Po ai, ai atje, çka don me qiri ne dore? – e gati sa s'bertiti. Tush Prendi, hajni me dorca te bardha, me qiri ne dore... Kuj ia ka ndeze? Zotit a dreqit! Besa, dreqit. Kur ke e ia merr at goxha qiri, e zvesh dhe ia then per shpine tue e rrahe... Ama, dhe keta priftent, shoke te mire kane!
Parakalimi i procesioni ende nuk mbaroi. Kola u merzit tue shikue, por nuk lonte vendit, se kerkonte dike me sy. Ma se fundi erdh dhe turma e mbrame. Kola u fut ne te. I kish thane zoti Filipi: duku neser. Dhe tash Kola, mbasi zoti Filipi asht me nje zotni tjeter, i del here pare, here per anash, here sjell kryet nga zoti Filipi, por ky si shifet ka biseda me randsi dhe nuk e shef. Kola vjedhtas prigjon biseden:
- A te bie nder mend, Filip, para pesembdhete- njezet vjet si ishin keta procesione?
- Eeeh! Atehere...
- Te kendonte zemra n'at mori popull, lavdi Zotit.
- Ndryshe atehere, zotni Zef, ndryshe asht sot...
- Po due me thane se djelmnia e soçme nuk merr pjese me gjithe zemer...Eeeh! na atehera...

- Epo fajin deri diku e kemi na; por ma teper e kane fajin do shkolla te reja qe na i kane çile tash...
- Tamam e ke. E kam nipin qe, me keni i emi, buk s'i nap me hanger, - sa hape gojen, blasfemon. Ruejna, zot, asht! Po çka t'i bajsh shkollave te reja? ...
- Po çudi asht puna e ketyne bolshevikve si njerez t'egjer ishin...
- Leni, allahile, - dhe sillej zoti Zefi me pa mos t'i prigjoje kush.
E Kola, qe gjithnje prigjonte, ne mjerimin e tij u qesh dhe tha ne vete:
- Te mos kesh frige mos kujto se po te padish kush se je bolshevik...
Kur pa se me zoti Filipin s'po piqet sot, i hyri nje idhnim. Mire e ndjeu se si i vloi diçka ne gjoks dhe shpejt si kokerr iu ngjit ne fyt. Aty u mbytte. E kujton shtepine, dhe kokrra ne fyt e mbyt. Te bertasin ne ket turme ndjenjash te serhollueme, te bertasin me te tane mushkni – dhe te shkyhet s'ka gja, te bertasin:
- Buuuke! Buuuke per Lilin!
- Hee… do buke? Kur te t'apin buke, ke per te kerkue tlyn, mandej mish e mbasandej ke per te kerkue shtepi me diell… heee – jo! S'duhet mesue bota njashtu. Jo! S'ka buke!
- Buke! Aman! Vdiq Lili!
- Jo, mos kujto se ka me vdeke. S'ka vdeke te na kush per buke. Per pashke ka me u gjet dikush, ndoj shpirtmadh, me i dhane ndoj lek.
Por Kola nuk bertet. Jo me fjale, por as me te dukunt te jashtem nuk don ta tregoje mjerimin e vet. Mundohet te buzeqeshi kur pershndet ndoj te njoftun.
- Si je, Kole? Si po shkon?
- O mire. Si je, ti Nike? – dhe buzeqeshja e perdhunt ia hap buzet.
Por kur shkon ne shtepi, aty ma nuk mund te lozi rolin e njeriut te kenaqun me jete. Buzqeshjen e vet e var ne dorzen e deres s'oborrit, para se te mbrenda. Duert i mban drejt shtatit qe grueja, e cila sigurisht e shikon neper dritore, mos te genjehet me shpres, tue mendue se ka prue ndoj gja. Por ma shpesh pret t'erret dhe atehere shkon ne shtepi…
Barem, atehere Lili asht ne gjum dhe s'ka me e pyete a i ka prue gja.

Buken tone te perditshme falna sot - II

Zotni Filipi s'kish dale ende ne kafe. Kola po e pret. Kanjehere e shndrron ndoj fjale me dy garsonat. Veren Kola si shkelqejne tryezat e gurit te bardhe, karriget e zeza me politure, - iu bane si me qene pjesa e nje trupi te tij te madh, nga i cili u shkeputen. Ndiente per ta diçka si nostalgji. I kujtohej vetja si, me dy-tri tabake mbushe me gota, sillej i lete tue sherbye, shpejt, pa gabim, paster. Atje m'at tryeze ne skaj vinte nje zotni, i huej, i cili gjithmone jepte bakshish. E me at bakshish ai i blente diçka Lilit. Zotnia kerkonte nje vermut dhe me ia ndeze cigaren. Keshtu ne mendime, nder mashtrime te gjalla aq thellohej Kola, sa gati i vinte te bertasi: Urdhno, zotni! Po vjen! – megjithse kafja ishte fare e zbrazet. Ishte koha mbasdreke.

Ulet Kola ne nje karrige. Po t'ishe ketu me sherbim nuk do te mund te rrinte, tashti barem njat privilegj e ka (o sa deshronte mos ta kishte). Ndej ne karrige, brrylin e mbshteti ne tavoline e ftyren ne shplake. Prap mendime. O mendime, fundi ju dalte! Se asgja s'po qitni ne drite. – Pese vjet pune ne ket kafe. E per pese vjet trajtat e te gjitha ketyne sendeve lane vrage te pashlyeshme. E bajne dhe shpirtin e njeriut qe t'u shembelleje. E shpirti i Koles asht coptue, ash shpernda grima-grima. Pak nga ai asht fute neper vrima te karrigave e te tryezave, te cilat Kola i njofti nje nga nje tue i kerkue, e pak nga shpirti i tij asht fute, asht ngjite, asht ngjeshe neper paçavra te ndyeta dhe mshisa te lagta. Atje, n'at tryeze – i kujtohej Koles- kishte gjithmone ma shum bishta cigaresh dhe gjithmon mbi te ose ishte shkarravitun diçka e pakuptueshme, ose vizatuem ndoj ftyre, ndoj trup grueje me tjera. E ai mbasi e shikonte mire e mire, e hapte paçavren e lagte dhe me aq fuqi e ferkonte, saqe tryeza lonte vendit. Duhej mshi mire, se qortimi i kercnueshem i zoti Filipit nuk mungonte. Pese vejt kesi pune. Dhe mandej ne rruge te madhe. Por as zoti Filipi s'ka faj. Pune s'ka. – Po kush kaf aj? – Askush. Nana qe me lindi, - une me shoket e mi qe apim te gjitha fuqite e veta per nje krodhe buke – dhe keto fuqite tona askuej s'i duhen.

Kush ka faj? – Kola thote askush s'ka faj – dhe aty qendron e tane tragjedia e tij. Vuejta intime deshpruese, e cila t'udheheq ne vetvrasje. Por mire ash qe Kola mendonte ashtu e jo ndryshe. Ta dinte ai se kush e ka fajin, ose se paku t'ia kishte vue ai vete kuej fajin, atehere – eh atehere... Fuqite e njerzve n'ankand kushedi si do te veprojshin.

Crrr-crrr-crrr bajshin kepucet e reja te zotit Filipi. Kola u çue ne kambe.
- Ej, Kolë? S'kemi gja te re? – por menjehere vazhdoi:
- A ishe dje ne procesion?
- Po, kam kene...
- Pak popull, s'ishte shume. Cudi, te rijt e soçem, si me i pase marre me dale ne procesion e me u vue ne rresh. Po ku ishe ti? Une s'te pashe.
- Isha mbrapa jush, zoti Filip.
- Eh, po, po, e dij. Une isha me zoti Zefin, bisedojshim per disa pune, por nuk te vuna re.
- Une erdha, zoti Filip, at pune qe me keni thane – desh te vazhdoje Kola, por s'e la ky.
- Kur isha une i ri, - filloi zoti Filipi me ftyre te qeshun dhe tue u ule ne karrigë – nje here keshtu ne procesion tue kalue, nje turk u qeshte ose lajkos, ose uratve tona, ose neve te gjithve, e une –eh, atehere me vlonte gjaku – dola nga rreshti ta kapa per fytit at qen bir qenit dhe zoti me dha nje fuqi te mrekullueshme, saqe gati e mbyta aty ne vend. Por u perzien tjeret, te dyja anve, t'u perleshen, une shpejt ika ne rresht, vazhdova rrugen ne procesion, kur mbrrini policia tue fishkellue dhe t'i rrasi ne burg nga te dy palet. Ha-ha-ha! Edhe sot, kur me bien nder mend, qeshem se si disa shoke te mi hangren dajak ne burg e une shndoshe e mire. Ha-ha-ha...E te rijt e soçem..., - vazhdonte zoti Filipi tue shikue neper dere.
- Pse mos te qeshesh, - bluente Kola nder mendime te veta, - shoket te kane hanger dajak e ti jo, ti s'ke hanger kurr dajak; por Pashkesh ose Keshndellash, ose ndoj feste te madhe si dje ke veshe kepuce te reja; e meqe vij me te lute per pune, m'i tregon pallavrat qe ke ba kur ishe i ri. Pse mos te qeshesh?!
Kola, i vramun, shikon zoti Filipin. Ky e din se Kola s'po e ndegjon, por vazhdon te flasi gjithnje ma me hare. Kish qellim te mire, si shifet. T'ia largoje mendimet nga mjerimi i papunsis, ta zbavisi, por edhe veten te nxjerri sa ma lire e mire nga borxhi kundrejt Kolës. Por se fundit, e pa se nuk shkon kjo taktike, prandaj ndrroi flete dhe i ra çeshtjes ne thelb.
- Po e din, ti Kolë, se punen tande gjithnje e kam nder mend?
- E dij. Ju falemnderës!
- Per Zotin, si per djalin tem mundohem. Te permenda nder dy-tre vende, port e gjith m'ankohen se s'kane pune dhe se nuk mund t'i shtojne shpenzimet… E une, ti po e shef edhe vete. Thuej, thuej due me ndie nga goja jote, a ma qet hesapi me te mbajte?

Kola disi i turpnuem nga fjalet kaq miqsore, mezi murmuroi:
- Po, nuk jua qet hesapi? – e ne vetvete vazhdoi: s'po fike me më mbajte derisa te gjej pune ngjeti...
- He pra, çka me ba? Ket krize, ket horrllek une s'e mbaj mend ndojhere. U bane lufta, u bane revolucione, por krize nuk kishim. Vlonte parja anembane. Shtrejtsi – po. Por ajo ishte per dobi tone. E sot, tek po kemi qetsi shyqyr, por ç'e do qetsine, more Kolë, kur asht kriza? Apo s'asht keshtu? Une, ti, na duem me jetue. Cka na duhet ne se po vriten tjeret... A ende s'jane vra-a? U farojshin. Pune, pune me fitue... Apo s'asht keshtu?
Kola pau se zoti Filipi prap po ia nis bisedes dhe bani sikur do me shkue.
- A, po shkoj. Tungjatjeta!
- Tungjatjeta. Kolë! Mos kij mendim. Gjithnje te kam nder mend. E sa per mue, ti edhe vete the se s'ma qet hesapi. Hajt, udha mbare...
Nga dera e kafes Kola u gjet ne rruge te madhe te qytetit. Diçka ia pickonte dhe ia digjte syt. Lot.
- Po pse me thrret? Pse me rren ne shprese, barem? Ah… - dhe kryevrare, dalngadale, me mendim te mpite nder tru se do ktheje ne shtepi prap pa gja, endej rrugave pa dite per vete.

Buken tone te perditshme falna sot - III

- Lil! Hajde, nanë, hajde, me ra me fjete, se te ka shtrue nana.
- Jo pra, jo! Aspak! S'due me fjete! Due me prite babën.
- Po baba vjen vone, moj nanë. Hajde, te paste nana.
- Jo, praaa...
- Po te dëftoj nje prralle te re te bukur.
- Cilen? - ngau djali nga dhoma e zjarrmit, iu avit s'ames dhe e shikonte me shkelqim ne sy.
- Nje te re... U, po te mesoj uratë...
- Jo, jo, s'due uratë, due prralle...
- Mire pra, prralle. Por edhe ti me e mesue permendsh?!
- Pooo - dhe u fut femija nder shtresa dhe e ama u shtri prane tij.
- Hajt, nanë, prrallen...
- Ndegjo, pra. Venia veshin mire dhe thueje ti mbas meje. Ati yne qe rri ne qiejt...
- Aty yne... uf... jo, jo, thueje ti vete ma pare.
- Mire pra: Ati yne qe rri ne qiell, shejtnue qofte emni i yt, te mbrije mbrentimi yt, te bahet vullneti i yt sikur ne qiell edhe ne toke...
- U nane, po kjo nuk asht prralle! Kjo eshte uratë! E din edhe Zefi, ia ka mesue gjyshja...
- E, a shef sa mire e din Zefi?... Duhet edhe ti me xanë.
- Mire, pra... Si fillon? - dhe strukej Lili ne prehen te s'ames. Kryet i mbshteti nder gji te saj, NDIENTE ERE NANE.
- Ati yne qe rri..., - shqyptonte nga nje rrokje e ama e Lili persrite. I ndalohej vemendja nder fjale qe s'kuptonte, por makinalisht vazhdonte te persrisi fjalet nga buza e s'ames.
- Buken tone te perditshme epna sotn, - vazhdonte e ama uratën.

Mbas ketyne fjalve te persrituna, Lili mbet:

- Buke te bardhe, nane, iha qysh kur s'kena hanger! - dhe çok kryet me ia pa ftyren s'ames.
- Hajt, tash me e thane ti vete deri ketu...
- Po... e dij. Si fillon?
- Ati yne...
- Ati yne, buken e bardha na fal...

T'amen e zu gazi, dhe nisi te qesh heshtaz, por e zu kolli:

- Jo, more... ti i re shum per shkurt...

- Uuu, kjo prralle asht shum e gjate, s'e due - jo, aspak, - u zemrue Lili.
- Sa mire Zefi e din uratën? E ti s'e din. Marre!
- Pooo, posi... ai nuk din asnje prralle qe dij une. Ai asht qyqe. Ta kam rrahe, t'i kam ra grusht, pse me ka thane se s'kena çka me hanger dhe pse s'ia kena pague paret per qira.
- Si, more, me i ra djalit te zotnis?! Te rafte pika duerve!
- Po fort, pra! Tash e mbys.
- Besa, s'guxon ma me e preke me dore... Jo, moj nane nuk duhesh me e rrahe Zefin..., - ndrroi e ama me te bute.
- Po, po pse me më thane ai mue se s'kena buke me hanger, - shfajesohej Lili e zani i dridhej gjithnje ma teper. Ishte gati te zhgrehet ne vaj.
E ama e muer me te mire. Ia kruente kryet. Dhe shpejt e zu gjumi.
Lili merrte fryme te rregullt. E ama u suell ne shpine dhe ashtu e shtrime ne shtrese kundronte neper gjysemerrsinen e dhomes. Llamba, e ulun gati krejt, leshonte ere vojguri nen tavanin e ulte te dhomes. Ia digjte cipen e holle te hundes se ftofun, nga e cila kullonte uje. Ajo e fshinte me gisht. Ndiente, ashtu e shtrime, si e terheq shtresa, e thith, e perpin ne nje gjum te rande si plumbi e te pakuptueshem si errsina. Por, mendimi, si nje korb i zi, ka ba çerdhen ne nje skaj te trunit ne rrashte, pjell te keqen mbas te keqes dhe s'len me fjete. Diku nga fundi i mides i doli si nje te dridhun, diçka si afsh i nje dashjes, i nje deshires, i nje nevojes se domosdoshme. Edhe çudi! Ashtu e lodhun, e undhsme dhe me shpirt e vujtun, ajo n'at çast deshronte, si net e para te marteses, t'i shtrohej deshirem me gjith zjarrmin e nje trupit qe vuen. Aty, aty asht harresa, shpetimi, e vetmja kenaqsi e jetes se saj varfanjake. Por edhe njajo pune bahet shpejt e hidhet si berthame e kumlles se gjelbert dhe pa pjek... Ne kesi nate, kur trupi zgjohet nga zjarrmi i etheve te mfshehta, njajo deshire asht si deshira e njeriut, i cili mbasi ka vendose te mbytet, hidhet n'uje, i zehet fryma, mbytet, mbytet me siguri dhe qe ndien kenaqesi bash pse mbytet.
Kola sonte ende s'ka ardhe, por ka me ardhe. Te vije. Kola nuk asht ma Kola qe ishte. Kola i mire, i qeshun, me duer plot qe vinte ne shtepi nuk asht ma, - por asht Kola pa pune. C'e do burrin pa pune? - i tha nje shoqe keto dite. Dhe grueja e votres nuk ndjen shume per burrin pa pune. Po burri me çka dallohet nga grueja? Jo vetem me pantallona, por me punen qe ban per t'i sigurue grues miregjendjen. Dhe pikerisht me njate

dallohet. E kur burri s'e ka at pune, atehere ç'e do? Te na leshojne vete ta fitojme jetesen, - por as njate s'te lane, te qesin ngatresa, - i tha grues se Kolës nje shoqe e cila gjithastu e kishte burrin pa pune. Ajo, bile, dhe i uha dhete leke. Dhe i tha:
- Kur te kesh nevoje te madhe, eja tek une.
Grueja e ndershme e Kolës desh t'i thoshte kesaj grueje: jo, moj grue, une nuk vij ne shtepi tande - pse e tane bota fliste per te se nuk asht e ndershme. Ajo desh t'i thoshte njashtu, por te dhet leket, qe i kishte shtrengue fort ne dore, i thane: ndal! Dhe ajo te gjitha ato mendime te keqija i kaperdin. E kur i kaperdin, nuk i duken gjithaq te keqija.
E sonte burri i saj ka me ardhe. Por, burri pa pune, a asht burr? Grues s'i bahet, s'i duket se asht burr. Dhe sonte kur te vije, ka per te hyme si ne shtepi te huej, pa te drejta dhe marreveshje. E nder shtresa, rate, kur dora ka me udhtue me gjete harresen, grueja ka me i thane: mos me prek!
Po Lili ç'ka pat? Pse u zbe qe nga maja e hundes deri te veshet? E syt pse i xhixhellojne ne zjarrmi? Mos e zu malli per baben? Per baben qe shkoi diku, nga do t'i bije çukulada...
- Mos harro me i prue Lilit çukulade, - i tha nana babës, kur ky me nje valixhe te shkyeme, marrun uha, nisej nga dera e me sy te turbullt shikonte femin.
U nis, shkoi ne kryeqytet. Atje, i thane, se ka me gjete pune. E keshilloi me gjithe mend dhe zoti Filipi. I dha diçka edhe per udhtim, uha. E shoqja nuk bezani fare kur i shoqi ia tha mendimin e vet. E Kolën, kur kjo s'bani za, diçka e theri thelle mfshehtas ne zemer. Por u nis, me vendim te preme qe t'u dergoje femis dhe grues sa me parë per jetese. Me gjith vendim te preme te tij, kaluen disa dit te mira e ai nuk i lajmoi gja shtepis. E shoqja priti dy jave rresht, dit' e nate, ndoj lajm, leter a pare, por kur s'erdh gja, e kojet e bukes munguen e vdekja ne rini nuk pritet me duer kryq, ajo ndryshoi jeten.
Po Lili? Lili çka pat? - Jo, s'e zu malli per babën. As per çukulade... Por u zbardh, u zbe qe nga balli nen floke deri ne bire te mjekres se holle, e ne mes te fetyres syt i qitshin shkendija.
- Nanë, uje...uje nanë, - dhe ne jastek sillte kryet here ne nje ane, here ne tjetren, me gishta qe dridheshin kapte safen e ujit dhe s'e leshonte pa e pi deri ne fund. E e ama ia terhiqte:
- Mjaft, moj nanë... Lil, mjaft ke pi...

Dhe per nje muej, i cili ka 30 dite, dite per dite e zune Lilin ethet. Kur ish nder ethe, i skuqeshin mollzat e syt zvogloheshin; e me tekaluemen e tyne zbehesh dhe qante ose pse nana nuk ia plotsonte deshiren, ose pse i pelqente te qaje. Me qa, kur ke vner dhe ethe, asht nje ngushllim ndosha, kushedi.
- Uf, si ma plase shpirtin, - i thoshte e ama kur ky qante. E Lili vazhdonte te qaje jo pse ia plaste shpirtin s'ames, por pse i pelqente te ndegjoje si i oshtin zani i vet nder veshe dhe i pelqente te qaje nga inati, nga inati. Pse mos te qaj? Po fort! - mendonte Lili me vete.
- Pse s'me nep, pra, buke te bardhe? E, pse s'me nep? - i sillej s'ames, e cila i kish mendet e humbuna dhe vazhdonte te qaje.
Pau e ama se si Lili u zverdh si drita e bishtukut e ethet nuk po e lene. Dhe e dinte se duhet me thirre mjekun, me ble barna, me i ba Lilit minester per me hanger, me pime limonade ne vend t'ujit kur ka zjarrmi, me u veshe trashe kur del perjashta, te gjitha keto i din e ama e Lilit, i ka mesue te zotnia kur, si vajze sherbetore, por...
Dhe nje dite, kur Lilin, mbas etheve te forta e zu gjumi, e ama e ndryni shtepine dhe shkoi te grueja qe i kish dhane uha dhete leke. Shkoi shpejt, pa kthye djathtas e as majtas dhe pa u mendue ma gjate, por me vendim te preme, si dhe burri i saj, per me gjete te hollat e nevojshme qe i duheshin per mjekimin e Lilit.

Buken tone te perditshme falna sot - IV

Dhe mjeku erdhi. Nje burr i shtyem ne mot me ungjill ne dore. Hyni tue shikue djathtas e majtas qe te shofi kend. I doli e ama e Lilit. Lili nder shtresa ish bame palmuç. Mjeku iu avit, nxori termomentrin t'ia veje nen sqetull. Por Lili, si duket u friksue nga termometri, ia nisi te qamit dhe i shmangej mjekut. E ama u avit, e mori me te mire, e perkedhelte, e puthte dhe se fundi mezi ia vune termometrin. Mandej mjeku e mori ta prek neper trup femin. Gishtat e ftohta te mjekut iu duken si thika Lilit. Dridhej i tane nga friga e mjekut, nga te ftohtit, nga vuejtja dhe s'dinte se ç'bahej me te. Veç kur e mbuluen dhe e lane te qete nder ethet e tij, mori fryme thelle me te tane gjoksin. Mjeku i kish rrudhe buzet dhe mendohej. Shikonte perqark e ne parakalim nder sy te tij pasqyroheshin plaçkat e nje shtepie varfanjake. Dritore me xhama te thyem e te ngjitun me leter, dy karriga jo te sigurta, nje tavoline e shtrembte mbi nje qilim te arnuem, ne qoshe fugeret e nder qoshe tjera pelhura merimangjash si trofejet e mshefuna te mjerimit. Se fundi, syt e mjekut u ndeshen ne syt e grues, e cila e shikonte me frige.

- Duhesh me u kujdese shum per femin, perndryshe do ta humbish. Shum kohe ka pase zjarrmi te madhe, - mezi iu kujtua mjekut me fole dhe mori te shkrueje receten. Kur u nis me shkue, grueja e pyeti sa duhet t'i paguaje. Por ky i tha ti blejne barnat me ato te holla. Ajo ulet ne nje vend si e mpime, shikonte mjekun, i cili iu avite deres s'oborit ne shpine mbrapa, dhe iu avulluan syt. Mbet ashtu nje kohe… Gjemimi i Lilit e terhoq. Ngau te djali, u shtri prane tij, zu ta rroki, ta perkedheli me fjale:

- Do shendoshesh, moj nanë, do shndoshesh, pellumb! Tash te blen ty nana me hanger te gjitha te mirat. Cka don me te ble?

Por Lilin, si shifet ne kete çast, s'e interesonte asgja, veç gjemonte, - dhe nuk iu pergjegj s'ames se gezueme nga mirsia e mjekut. E ajo u mendue, diçka si me e piskue per zemer; mendoi se ndoshta mjeku s'i muer te hollat nga se Lili ka me ... "Jo, jo, - peshprite, - ruejna zot!" Dhe me frige e shikoi djalin, e mbuloi mire dhe u çue.

Sahati i kishes trokiti nje here, ishte tre e gjysme mbasdite te vjeshtes se dyte. Grueja u çue me vrull, shkoi ne dhome te zjarrmit dhe ne sqoll nisi krizma e enve dhe e ujit. Mbasi u la mire dhe u mshi, iu avit pasqyres te cilen ia kish dhane uha Lezja, gruaja e dhete lekeve. Mori krem, e ferkoi ftyren e nje ere e kandshme u perhap neper dhome. Neper rete e pudres

grueja shikonte veten ne pasqyre dhe kujdesej sa ma natyrshem t'i skuqi buzet. Jo jo, s'jam plake! mendonte. Ti je e bukur, moj dreq! – E kur burri s'ta çon asnje leter, e ti me femi po vdes unit, besa ti je e marre, - i tha Lezja. Dhe ia rregulloi punen.
Lili i kish qite kryet nga mbulesa dhe me sy xhixhillues shikonte t'amen. Mezi e njofti. Kurr s'e ka pame nanën kaq bukur te veshun e te goditun. Kjo iu avit, e çoi, e mbeshtjelli me jorgan dhe ne gryke, e mori ne dhome te zjarrmit. I shtroi prane votres dhe i tha te rrije urte se ka me ardhe nje zotni ne dhomen tjeter. Lili shikonte t'amen me admirim fminuer, gati ishte te rrafi shplakat nga gezimi. Por kur i foli kjo seriozisht per ardhjen e nje zotnis ne dhomen tjeter, ai s'bani za; si duket e kuptoi randsin e çastit. U shtri rate, u mbulue, u struk, u mblodh dyfish si krymbi dhe me sy te mbyllun shifte nanën aq bukur te veshun e te goditun. E e ama, mbasi kish mshie dhomen dhe ndreq, aq sa mund t'u ndreqte, kish qendrue ne mes te dhomes ne mendim. -Mos rri e vrame, se burrat s'kane qejf ashtu me e pame gruen, - e mesonte Lezja. – Qeshu, fol, mos rri si qyqe. E ne rase se te pyet kush pse çon keso jete, ti thueji si te duesh, mundesh me i thane te verteten, por thueja tue buzeqeshe. Mos gabo me te shpetue lot, se ai burr nuk te kthehet ma kurr. Por qeshu, fol, ban lojna. Une e dij, moj moter, se ty m'at çast te pelset zemra, por çka me bame... per hater te djalit qe e ke te smunde... dhe jeta duhet jetue, te e mbramja, s'asht edhe nje pune e madhe! Tjeret i bajne keto pune per qejf, e na i bajme per hall, - i tha Lezja ma me za dhe tue çue duert perpjete nga zemerimi qe duhet me i thane kto fjale qe t'ia mbushi mendjen per nje pune aq te thjeshte.
Tash ajo qendron ne mes te dhomes, e goditun per me prite... Te gjitha mendimet mallengjyese dhe jomallengjyese, fundojne te keshille e Lezes: buzeqesh! Ajo iu avit pasqyres, buzqeshi dhe i pelqeu vetvetja. S'kish dijte deri tash se ishte nje bukuri e mshefun.
Tingelloi ora kater. Grueja shikoi neper dritore dhe qe: ne oborr po vjen i prituni. Ajo mblodhi fuqin, e nxori prej dikah nje buzeqeshje, e vendosi mbi fetyre te vet dhe i duel para mikut te pritun…
Posa hyni Kola ne rrugzen ku e kish shtepin, i nguli syt mu ne dere t'oborrit qe prej se largu. Pau se bash nga dera e shtepis doli nje zotni i huej, i panjoftun. Kolës diçka i ra ne krye. Si me i pase shkrepe dikush per mur. Zotnia i panjoftun kaloi ne drejtim te kundert te rruges, ngadale, i qete. E Kola e ngadaloi hapin. Gjithfare mendimesh si shigjeta ia

pershkojshin trute. Por asnje mendim nuk ishte qetues, as nuk i fashite ndergjegjen e tij te çueme peshe ne dyshim. Me hap te sigurt hyni neper dere t'oborrit. Dyert e shtepis, dritoret, ne vrullin e mendimeve te hidhta, i lojshin para syve, iu dukeshin dyfish, shtrembet, gjithsesi. Praku i deres shkonte e vinte. Ne dritoren e dhomes se zjarrmit pau nje grue shume te hieshme, dukej se numron te holla. Thellte, ne ndergjegjen e tij t'ersueme, vegoi nje rreze e vogel shprese: ndoshta grueja e tij nuk banon ma ket shtepi! Do te kete dale vete, ose do ta kete qit jashte i zoti per mospagim qiraje. S'ka gja… Ma mire njashtu… se njerzit e huej me ardhe te grueja e tij, - mendonte Kola msheftas, tue e mshefe dhe nga vetvetja at mendim. Por sa kaperceu prakun pau plaçkat te cilat i ka lane. U zhduk ajo rreze e vogel shprese. Si nje i plagosun rande, u ul ne karrige, disi u mblodh e shikimin e mbertheu pertoke. Po ajo grueja ne dritore? – mendonte. Para atij erdh grueja, e cila se parit, me te pame te shoqin, u hutue, u zbe. Kola çoi kryet, ne gruen e dritores njofti gruen e vet. Po, asht godite per at zotnin, - mendoi. Uli prap kryet dhe shikimin prap e mbertheu pertoke, ne nje vrime nder drrase. Heshtje. E zemra donte t'i bertase, t'ulerije si bisha se ciles i kane prishe strofullen. T'ulerije, por s'kish fuqi. I shkyem, i lodhun, i mjeruem rrinte ke karriga pa levize. Grueja, kur e mblodhi veten, e pyeti:

-Kur ke ardhe?

-Tash..., - u pergjej shkurt pa drejtue kryet nga ajo.

-Lili asht shum i smunde, - i tha e shoqja.

Por ai vazhdoi te shikoje pertoke vrimen nder drrasa. Ishte nje vrime shume interesante!

PUTHJA E CUBIT

Edhe një prandverë ka ardhë. Prandvera e 17-të për Dilen, e cila, e shtrime në bar, ndjeu se ka taman, as më pak as më tepër se 17 vjet.
- Nano! Savjet kam? - pyeti nanën në shtëpi.
- Tashti i mbushë 17, bijo! - I tha nana me një dorë n'ijë e me tjetrën mbi sy, për m'u mprojtë nga rrezet e diellit.
Edhe Dila, e shtrime në bar, ndjeu se ka taman 17 vjet. Ashtu e shtrime, shikon qiellën e kaltërt dhe ndigjon cingaret, një të dashit të grigjës ma e hollë, dhe tjetra e lopës me za ma të trashë. Çohet herë herë e shikon bagtinë dhe prap shtrijet, me një dëshirë të vokët në gji. Sa fort Dila që i ndjen të 17 vjetat në vete! Kur në të kapërthyemit e dëshirës, ven shplakët në krye dhe ma fort shtrihet, ndjen si nder veshë dhe nder tamtha i rreh gjaku rrjedhje të forta dhe e ban me ndie edhe me dishrue ma tepër. Atëherë Dila mbyllë sytë. Ashtu me sy mbyllë pret diçka. Buzët e saj të lagta e të çeluna për gjysë i terte flladi i lehtë.
Para ksaj prandvere bani një dimën acar. Bora që tashti shifet si kunorë vetëm nder bjeshkët e nalta, në dimën kish mbulue mbarë tokën. E stuhia e tmerrshme s'kish lanë pa futë borën deri ndër shpella mali dhe zgavrriqe drunjsh. Në këtë acarim dimri dhe bishët e malit zbriten nëpër katunde te njerëzit. Por kta nuk i priten mirë. Bashkë me bishët e malit zbriti edhe Cubi, i cili ishte tmera për ata që kishin ndigjue për të e që nuk e njifshin. Në besë, në buk'e krypë, i ati i Diles e mbajti cubin si mik. Dhe gjatë një mueji sa ndenji Cubi në shtëpi te saj, Diles iu ba se ky Cub nuk asht ai Cub për të cilinflisnin se vret, grabit, përdhunon. me të vërtet po at emen kishte; por jo nuk ishte ai. Cubit mik njezetekatërvjeçar i buzqeshej nana, i buzqeshej Prenda, e shoqja e re e vllaut, baba i fliste me za të butë e vllau këndonte me te. Cubi-mik ishte i mirë dhe të gjithë e nderojshin, Dila kanjëherë me dashje dhe pa dashje e shikonte në sy dhe kuqej, kanjëherë me dashje e pa dashje, tue bamë punë nëpër shtëpi, në të kaluem e prekte me krah dhe nga kjo prekje iu rritshin gjitë. As nga armët e tija, rrypat me fishekë, pushka dhe revolja nga të gjitha këto Dila s'kish frigë. Një ndjesi e fshehtë rritej në zemrën e Dilës dhe sa ma shum ditë kalojshin aq ma e madhe bahej. Dhe ndiesia u ba dëshirë, dëshirë që të len pa gjumë.

Por një ditë, kur dielli sa një pare e madhe sermi u çfaq në qiell, Cubi shkoi. E dila mbet vetëm me dashurinë për Cubin.
Asht e flakët dëshira e Dilës në një ditë të shkëlqyeshme prandvere kur, e shtrime në bar, ndjen se si i rreh gjaku ndër dej. Asht edhe ma e flakët dëshira e Dilës kur i ka syt'e mbyllun e me andrim vezullues don me krijue ate që s'ka. S'ka… Nuk u pa ma Cubi. E 17 prandvera të saja janë 17 thirrje të nxehta të heshtura drejtue Cubit.
Ashtu e shtrime dhe n'andrim Dila nuk desht t'i çeli syt' edhe se ndjeu mbi trupin e vet një peshë dhe prishi dihatunin e nji mashkulli e mbi buzët e veta të përvlueme një njomsi. S'i çeli syt'. Ndoshta kish frigë të mos prishi ekstazën në të cilën kishte ramë… E kur ndjeu lehtësimin e trupit i çeli syt. Por aty s'pa kend. U hodh nga ana e majt. Dila u drodh. "Ai asht! tha - Cubi!" dhe u vue në ndjekje të gjurmës majtas. Sie dehun, gjithnjë n'ekstazë. La grigjen, as që i binte ndër mend, pse kërkonte Cubin. Doli në rranxë të malit shkambuer. E thirri me emën, por bashkë me këmbët e saja që përplaseshin prej shkambit në shkamb, q'ashtu dhe thirrjet e saja u përplaseshin - kot.

***
Një parandjenjë i thoshte se ai është afër , shumë afër dhe sikur e ledhatonte me atë shiqimin thumbues, u ndal dhe hodhi një vështrim si të ishte vëzhguese profesionale, e krehi me shiqim tër bjeshkën e lartë që sikur bashkohej me qiellin. Mbledhi forcë shtrëngoj duar dhe filloi të thërrs:
o Cubiiii
jehona e thirrjes si oshtimë vullkani, përplasej nga shpati në shpat duke krijuar jë eho të pafund dhe përseritej; o Cubiiii, o Cubiiii, o Cubiiii, ….
Dilo u step Ju duk e quditshme, se si përseritej thirrja e saj.
sikur e harroi Cubin u thellua në mendime dhe mendja i vajti ke gigja në bregun e shqipes. Hudhi bistekët anash, u kërrus ti shtrëngon të mbathurat, dhe u kthye nga kishte ardhur, bri përroit që kishte një gurgullimë uji me karakteristikë të vëqantë. Papritmas dëgjoi një thirrje të fuqishme: Dilooooo, ilooooooo, looooooo,
Është Cubi, tha.
Shiqoi rreth e rrotull por nuk vërejti askund Cubin, o zot ç'ndodh me mua, është ky një ankth ëndrreje apo ç'është duke ndodhur, nuk kuptonte më asgjë. Nuk vonoi shumë dhe Dilo shpejtoi hapat rrëzë proit që thente

monotonin që ia brente shpirtin Dilos, kaloi edhe gurin e Plakës dhe për një çast filloi ti rrahën zemra furishëm, drejtoi shiqimin dhe me gjymës zëri tha Cubi, Dilo… Nga ky moment ajo nuk shiqonte nga e bartnin këmbët, për një çast u gjend në përqafimin e Cubit me trup vigani, puthjet e njëpasnjëshme, qetsuen dy zemra që vlonin nga dashuria.
Cubi ishte kurreshtar dhe e ngacmon Dilon.
O Dilo, ke humbur gigjen apo si erdhe këtej ke guri i Plakës?
E ajo shkurt.
Më mungoje ti, e ndjeva se je afër andaj të kërkoja matanë, ke shkëmbi i trimave dhe ja të gjeta, desha të të tregoj se jam rritur, edhe unë mund ta mbaj pushkën krah për krah me ty.
Apo të dukem ende e re?
Cubi e dëgjoi me vëmendje dhe mburrej me Dilen sa e vendosur që ishte.
Hë ç'thua fol pyste Dilo?
Cubi u kërrus lëshoi pushkën rrëzë një Bredhi t'badhë, ia vëri njëren dorë mbi krahun e Dilos, u bashkuan shiqimet, sytë e Dilos shkëlqenin, fytyra saj ishte kapluar nga një zjarr i paparë më herët.
Dilo je e vetëdijshme se jeta në male nuk është e lehtë?! pastaj….
Por Dilo kthej shpinën dhe nuk dëshronte spjegime, ajo dinte se çdonte, kishte vendosur.
Një lot i rrëshqiti nga faqja si zjarr, pastaj tjetri. Cubit i erdhi keq për Dilon, ai nuk e kishte të kjartë a janë lot dashurije apo lot vëndosmërie për Liri.
Dilo ti po deshe mund të vishë, por je ende e re andaj prit edhe një vit e të hedhësh shtat dhe një çik.
JO Cubi, unë nuk pres dot më, mjaft kam pritur, unë dua të jem me ty.
Prap një vrushkull lotësh vërshuan faqet e Dilos!
Cubi ia vëri duart në bel me dorën e majtë ia fshiu lotët e vakët dhe i tha unë nuk të them po pa e marrë pelqimin e prindërve të tu, kjo është luftë Dilo. Ajo e gëzuar shumë iu hodh në përqafim Cubit duke e puthur si e qmendur, ngase e dinte që prindërit nuk do e pengonin kurr Dilon të jet perkrah Cubit trim.
Me ardhjen e Pranverës lindi edhe një dashuri e re, edhe një pushkë për Liri.

A do qymyr, Zotni?

Dy thas qymyr mi kal. Prane, malsorja. Trotuari me bllok dyqanesh djathtas, ashtu edhe majtas. Kali dhe malsorja ne parakalim. Qymyri ne konkurs. Shikon Njeriu - artist dhe ia prish syte kjo dis'harmoni. Nje disonance e vrazhde. Malsorja i fryn hundet, prodhimin e njesh per trotuar dhe gishtat i fshin per xhublete. Veprim i thjeshte, por motiv delikat per nje piktor. Thupra ne dore te malsores zhgrryhet pertoke dhe shkruen nje vije kilometric gjate rruges. Qashtu malsorja nenvizon mendimet e veta.

- A do qymyr, zotni?
- Sa?
- Dymbedhjete leke... Po ndalu, thuej ti sa. Pse po ik?
- Ne ket vape dymbedhjete leke? - pyet nje tjeter tue perqeshe.
- Po sa jep ti, pra?
- Jo, mue nuk me duhet.

"Vertet vape ban. Pa kujt i duhet qymyri. Po e mbaj dhjete leke", mendon malsorja dhe ec neper hije rruges se qytetit. Kali leviz ne symbylle. Ndoshta andrron. Tash ne pleqni andrron dashin e dikurshme te peles. Malsorja s'e nget. Nuk e trazon ne knaqsi te tij te pamvarshme. Asht duruesae. Kur dalin ne diell, perdhe zhgrryhet nje hije. Dy hije. Dy hije te ngaterrueme, te kaperthyeme, hija e kalit dhe hija e malsores. Nuk mund ti dallojsh keto dy hije. Nuk mund t'i keputish. Njana pa tjetren nuk shkojne. S'kane vlere. Se vetem bashke perbajne nje tansi. Nje tyansi jetsore. Krk- kkk kthehet qymyri ne shpine te kalit, krkk, krkkk, krk dhe krismat monotone te patkonjve te kalit, qe ndeshin per gure.

Malsorja con kryet. Shikon diellin... koha me u nise. Me u kthye ne malsi. E qymyri s'u shit. Vendosi ta japi ma lire.

- O ti djale, sa asht sahati?
- Djaloshin e terheq bukuria e malsores. Miqesisht i afrohet dhe i thote sa asht ora. E pyet sa e mban qymyrin. Ban pazarllek, edhe pse s'ka qellim ta bleje. Por malsorja asht e bukur dhe e re. Pse mos te kuvendoje pak me te? "Asht e ndyte, - konstaton djaloshi. Sa teveqele jane keto katundaret. Nuk te kuptojne. Duhet me i thane... dhe ate qe nuk thohet." Keshtu mendon djaloshi dhe e shikon malsoren si bir zotnie sherbtoren e re te veten. "Teveqele! Teveqele! S'kupton asgja!". Dhe djaloshi shkon ne pune te vet. E malsorja fillon te shqetesohet per kthimin ne malsi. Shikon

diellin, si gjithnji po afrohet nga perndimi. Si ka per tu kthye ne malsi neper terr? Me te vertete, ajo nuk dron prej lugetenve dhe bubazhelave por... t'ishte plake nuk do kishte aspak frige, por... Kujtohet si nja dy tri heresh i jane vu mbrapa do njerez, dhe se pari se c'lypshin prej saj... Pra, nuk i dron bubazhelat si qytetaret, por njerezit... Njerezit i ka ajo frige. E pse? Pse asht e re dhe pak e bukur.
- Nje dhimbe e kandshme shtrengon zemren e malsores.
- Sa e ke at qymyr fisnike?
Malsorja siellet. E njef njeriun q'e pyet. Ia ka shite edhe nji here qymyrin. I thote:
- Tete leke!
- Jo, shtrenjte e ke... Me ke idhnjue ate dite, - i thote njeriu dhe shikon majtas e djathtas.
Malsorja qeshet, disi e turpnueme. E mshef ftyren. Kuqet.
Malsorja qeshet, disi e turpnueme. E mshef ftyren. Kuqet. Nuk i con syte ne njeriun. Pyet e frigueme:
- Sa per ty pra?
- Pese!
- Merre shtate!
- Hajde per gjashte!
Malsorja rri pezull. Mendohet. Shikon diellin - Ia pash hajrin! - thote, dhe i shkon mbrapa blesit. E ai njeri q'aty , ai qe tash po ec perpara saj, peshon shume rande ne kujtesen e malsores, e cila kuqet e skuqet nga turpi.

Vetvrasja e trumcakut

Dhe trumcaku vuente nga melankolia. U lind në një vend me të vërtetë të shkretë. Në vend të barit bijshin qime e derrit e në vend të pemve - brinat e një shtazës parahistorike. Dhe në këtë natyrë - e cila nuk mund të quhet natyrë - kush mos të bahet melankolik? Dihet se një trumcaku s'i duhet shumë për jetë, por natyra, e cila nuk ishte natyrë, s'i epte as aq. Mos pyetni si e tek u gjet trumcaku n'at vend, dhe si e tek u gjet njeriu në këtë pike kozmike; nuk dijmë shumë. Hipoteza dhe andrra. Miliona vjetësh dhe një fjalë goje, si për shembull: "…të bahet dritë! Dhe drita u ba!" - A shifni? Një fjalë magjike! Hokus-pokus! Sa bukur!

Dhe unë thash: të bindet trumcaku në një vend ku në vend të barit bijnë qimet e derrit e në vend të pemve - brinat e një shtazës parahistorike. Njëherë trumcaku qëndroi mbi një brenë. U mërzit të shikojë qimet e derrit, u mërzit të fluturojë prej brenës mbi brenë. Nga mërzia dhe idhnimi mbylli syt. Ra në pikllim melankolik. Njeriu me temperament melankolik asht inteligjent. E inteligjenca në kuptim ma të hapët të fjalës, pakkuj i solli qetsi dhe të mire.

Dhe trumcaku, në majë të brenës e në kulm të melankolis, vendosi të vritet. Plot ironi filozofike shikonte rreth përqark vetes e vendimi i patundun mirfilli pasqyrohej ndër syt e tij të dëshpruem. Cicrroi një here, cicrroi dy here; cicrroi tri here. Mandej një crrrr e gjatë e plot mallëngjim ishte porosia e tij e fundit. Testamenti i dhimave të tij. Dhe, pa u dhanë krahve, këcej prej brenës… ra mbi një qime të derrit, të gjatë e të mprehtë si thika, dhe u ngul mbi të.

Trumcaku i ngulun mbi një qime të derrit. Me krahët dhe puplat e tij lonte era dhe e sjellte rreth qimes, si sillet dhe gjeli metalik në majë t'oxhaqeve tona. Atbotë frynte veka janë këto kapërcime logjike! Ka me bërtitë ndokush.

Po, lexues i dashtun e jo i cekët. Po! A pak po kemi kapërcime logjike, morale dhe dogmatike në botën tone reale? Pse po zemrohe dhe po don me më gjykue për disa kapërcime logjike askuj damsjellje?

Zoti te dhashte

Dikush trokit ne dere...
- Kush a?
- A po na fal ndoj send, zoje?
- Zoti te dhashte!
- Me fal ndoj send, te dhashte Zoti shendet...
- Hajt! Zoti te dhashte!

Por lypesi e di se c'domethane "Zoti te dhashte": Mos me pas kurr, mos me ngran kurr. Prandej me ma teper fuqi i bie deres. E tash permrenda asht zani ma i rrepte:
- Hajt more! Zoti te dhashte! A merr vesht?

Lypsi doemos i duhet me marre vesht. E len ate dere, msyn te dyten, te treten, te katerten, e keshtu me rradhe, te gjitha dyert e asaj rruge. Kjo rruge sot per sot asht fusha e veprimit te tij. Neser asht ndoj rruge tjeter. Fushat e veprimit te qytetarit tone jane te ndryshme. Dhe ndryshojne njena nga tjetra, sic ndryshon parajsa nga ferri, me te gjithe variacionet piktoreske dhe mallengjyese. E lypsit, qe trokit nga dera ne dere, diku ia falin ndoj send, diku i thote zoja e shtepise: "s'kam besa" - dhe lypsi athere asht i bute, shkon tue mbajt mend kete dere, me ardhe ndoj dite tjeter. Por at "Zoti te dhashte" lypsi s'e duron; s'don ta degjoje. Ai e din mirfilli se c'do me thane "Zoti te dhashte". Edhe ate, i cili percjell me keto dy fjale, ai fillon ta mnije. Kurr ai s'i ka ndame keto dy fjale njenen nga tjetra. Kudo qe degjon fjalen "Zot", ai pa dashje ia shtonte ate "te dhashte" dhe ne tru te tij u krijonte dicka qe s'kuptohet e qe mnihet. Se ai ishte i sigurt se "Zoti te dhashte" domethane tallje.

Nje dite, me nje buzeqeshje ironike, duel lypsi nga nje ndertese me kryq ne maje, se aty kishte veshtrue keto fjale: "Zoti qe kujdeset per zoqte e qielles, s'ka me i lane njerezit te vdesin nga uja". Hee - thoshte lypsi tue dale - sot nuk asht njashtu. Zoti ndoshta kujdeset pet trumcake edhe priftent, por per mue s'e besoj. Mue dhe shoket e mi, po na harron bota e si mos te na harroje Zoti, qe s'na ka parasysh. Por thone, se Zoti... ketu lypsi preu mendimet dhe shpejtoi mbrapa nje plaku me bastun.
- Zotni, te lutem, me fal ndoj send...
- Zoti te dhashte!

Lypsi shtrengoi dhambet per ta ndale gjuhen, e cila ishte gati te kaloje kufirin e bjerzis. Shtrengoi dhe grushtat, e thonjt qe tash sa kohe nuk i

kishte te preme, iu ngulen ne dhanat e duerve. Perpara vetes nuk shef asgja tjeter, vec objekte mnie. I bjen nder mend, koha kur s'ka pase nevoje me lype. Perkundra. Kujtohet si i ka ndihmue lypsat qe vijsnin dite shtune ne prakun e dyqanit te tij, kur ishte farktar... E sot? Atij pak kush i ndihmon, pse jane shume lypsa. Kujt i epet ma pare? Arsyetonte lypsi se fundi. Por mnia vetvetiu, pa arsye, rritej e pushtonte zemren e trunin e tij dhe m'at cast donte te shfreje ne nje menyre makatare tue rrahe hekurin e kuqun. E kur nuk ka hekur dhe cekic. Puna del e dyshimte dhe e rrezikshme.
Prandaj me taktik, zotni, mos thoni "Zoti te dhashte!".

Kanga e trumcakut

…(i) lodhun, dhe ma i pakenaqun trumcaku me fat, qendron mbi dege. Me urrejtje shikonte natyren qe s'e krijoi ma artistikisht. Me perbuzje verente bylbylin. Tashma e kuptoi mirfilli se duhet te vueje nga fataliteti i gjanave! - Keshtu tue mendue ndjen nje lehtesi trumcaku. Ne thellsin e ndergjegjes se tij filloi te ndjehet filozof. (Kish te drejte!, se kush arrin nder trute e vet te jete i pakenaqun me fat, ai me te vertete fillon me bame filozofi – dhe nje filozofi ma te vertete se cdo tjeter filozofi). Cuditej trumcaku per madheshtine e ndjesive te tij dhe çuditej per fatalitetin e gjanave. Pse asht trumcak, vetem pse asht trumcak nuk mund ta thote kangen e bylbylit. Cuditej per padrejtesine e natyres dhe ish gati te baje diçka: nje kryengritje kundra natyres!... Por, trumcaku filozof e mundi trumcakun harbut. Me nje indiference apatike fishkllloi dhe flturuoi nga dera nen strehe te pullazit. Dhe aty ia nisi: Ciu-ciu e ciu-ciu, ciu-ciu si filozof cinik e faqezi.

Ky paradoks i trumcakut mund te ngjaje edhe nje milion vjet, kur truni i trumcakut te zhvillohet aq sa asht sot i zhvilluem truni i njeriut. E na, njerzit e ketij skaji te Dheut, per nje milion vjet mund t'arrijme qe mos t'ia kemi zili njerzve qe rrethojne (si trumcaku qe ia kish zili bylbyli). Nje milion vjet – afat i bukur...Si ju duket? – Jo, jo nuk asht shum. C'jane nje milion vjet pare eternitas…

Sanatorium, Prill 1938

*Faqja e pare e doreshkrimit ka humbur.

Idhuj pa krena

Nje tufan i tmerrshem i shembi idhujt.Disa i bani pluhun e disa i la pa krena.Tufani i tmerrshem nuk fryni as nga nje ane e horizontit,dha as nga qiella ,por duel nga zemra e dheut .Cdo gja qe del nga zemra asht ose perkdhelse si andja me intime ,ose e tmerrshme si tufani qe shemb idhujt.

U tret pluhuni i idhujve q`u shemben krejt,dhe s`u mbet fara,e idhujt qe mbeten pa krena qendrojne si deshmoret e shemtuem e nje jetes se perndueme.

Idhuj pa krena!Shemtim i natyres!E njerezit qe jetojne ne mes tyne enden si te harlisun.Ata qe kishin lindun para se t`u shembeshin idhujt dhe i pan me syt e vet ne bukurine e tyne ceremoniale ,ata tash renkojne ,psheretijne per kohen e idhujve te vjeter,dhe tue vdekun shpresojne se keta idhuj do t`i shpetojne .E ata qe lindin ne kohen e idhujve pa krena s`dine ka t`ia mbajne .Duen t`adhurojne ,po c`ka t`adhurojne ?Idhuj pa krena?...Duen te besojne ,por c`ka te besojne ?Idhujt pa krena?Kush mund te adhuroje te shemtuemen ?Kush mund te besoje ne nje zot pa krye?Cdo gja qe s`ka krye asht kufome e kufoma s`e ka vendin mes te gjalleve.Kufoma duhet varrose.Perndryshe ,e perlyemja me te ka per te qene katastrofale .E katastrofa asht katastrofe!Zhduk kombe!

(Kombi yne me te vertete s`u zhduk.Por arsyeja asht vetem se dhe kojshite tone t`aferm qene pak a shume te nje fati si ne.)

Idhuj pa krena!Flite e kohes ,e cila gjithcka perpin ,dhe fli te fatalitetit.Qendrojne ashtu te gjymtuem vetem e vetem pse s`duel njeriu i zoti te ndertoje idhujt e ri.Por,heret a vone ,ai do te dali .Dhe idhujt e ri qe do t`i ndertoje ai ,kane per t`u adhurue nga turmat .Se landa e tyne ka per te qene moral i kohes ,model`i tyne -njeriu i socem.

Idhujt pa krena!Ne varrimin e tyne kumonet kane per te plase se ramit,minaret kane per ta thye kurrizin se faluni dhe zhrecve do t`u keputen telat e fytit se kenduemi.Dhe do te vije heshtja.Se cdo vikame fillon dhe mbaron me heshtje .Mbasandaj do te filloje puna...

Husarët n'Adriatik

Nga Tirana ne Durrës shndrruem tre automobile. Jo per qejf! Por pse i pari na hudhi ne hendek dhe bani stop si me i pas ra pika, te dytit – posa erdh nga Durrsi dhe u ndal para nesh – ia zu ngerçi frejt dhe s'u leviz ma, e te tretit mu ne Durrës i mungoi benzina. Fati yne qe anija nuk ishte gjermane, te niset n'ora 9 perpike simbas orarit. Nuk ishim dhe pa fat si na tha shoferi i automobilit qe iu prishen frejt: siete infortunati (jeni pa fat). Na mbante per italiane.

-Deti asht i qete. Kemi me udhtue mire, - me thoshte shoku dhe, i inkurajuem, me tregonte se si njeni qe e kish shume frige detin derisa ish n'ani tue udhtue, e uronte detin: O det i bekuem, sa i madhnueshem je, sa e madhe asht mirsia jote, ti lidh te gjitha qytetet e botes, bashkon te dashtunit, miqte dhe armiqet.... Por kur kambet e ketij frigacaku preken token e sigurte, ai u suell detit dhe e peshtyni: Fuj! Te marrofte Zoti, ti katil...he...gjithkuj ia more shpirtin...dhe shaj detin me goje te plote.

-E bukur qenka... i thashe shokut dhe shikojshe bregun te cilit ju largoheshim. Madhshtia e detit me bani te mendoj subeternitas. E humba ndjenjen e kohes ne te cilen jetoj dhe me shkoi mendja te stergjyshnat tone, husaret qe mu ne ket uje, nder keto dallga husarojshin dhe plaçkitshin anijet e pasuna te romakve. Kush mund ta parashifte se dikur, mbas mija – vjet, sternipat e ketyne husarve ilirë me sternipat e romakve te pasun, kush e mendonte se do bahen miq, dhe miq kaq te sinqerte?! Nga miqsia e madhe te rroken e te puthen, t'i ndihmojne shoqi-shoqit me rasen e ndoj disfates.

-Aaah!... – zani i shokut me solli ne vete. Ish zbeme dhe syt iu ishin zmadhue. Po fillon, - tha, i shtrengoi dhambet s'e shikonte me sy detin. U ulem poshte ne barkun e anijes. Shoku zuni vend dhe u shtri si ne tabut. E anija – here dridhej korrizi, here lekundej djathtas e majtas, here vente poshte e nalt. Po mos ta kishte njeriu miden ne ket rase, do bante qejf. Po njeriu do bante qejf dhe ne shume rasa te tjera po mos te kish miden. Sidomos ne, sternipat e ilirve, do t'ishim te lumtun pa mide. Nuk do vuejshim as ne toke, as ne det.

(Po, ç'e do dhe jeten pa mide? – mendoj bashke me ata te cilve midja u bluen ar e diamante. Po, ç'e do jeten pa mide?).

Shikoj djathtas dhe majtas. Te gjith pothuej kryevrare dhe te zbeme, t'emocionuem nga inspiracioni ne mide... – E anija – i dridhej korrizi,

lekundet djathtas, e majtas, shkon posht pernjehere. Njashtu qe ne, udhtuesit, ndjejshim ne nje kohe se ngjitemi ne qiell pa mide, si zbrasim ne ferr pa krye dhe si persri pertypshim gjellen e drekes qe na u kthente ne goje.
Baaau!...Ia ve shokut doren mbi sup. Qendro, qendro! – i tham. Baaauu! Prap ai. Qendro, bre! Si kane qendrue idealistat e mdhaj te botes te cilet nuk e kane qite kurr at gja qe pa ngushllime te mia, se edhe mue me sillej kryet verdalle.
Nisa te vuej edhe une dhe shikojshe perqark. Ndegjojshe se si anijes i bante korrizi krrk – krrk. Dhe mue me bante po ashtu korrizi, megjithse s'i shembellej anijes. Shikoj. Njeni, ishte shtrie ne poltron, duert e zbeta iu varshin dhe s'i hapte syt nga deboleca. Njenit, si shifej, iu ish permbys keqas midja dhe iu ishin zbardhe krej syt. Nje tjetrit, qe s'kish ngrane, i kishin ardhe mushknite mu ne fyt. E njenit ne nje skaj t'errte i kish dale zorra neper vrimat e hundes dhe i zvarrisej neper toke.
Prap i avitem shokut i cili ish zbe dhe shtri si i vdekun. As i hap syt. Une i avis buzet e mia te veshi i tij dhe i flas: po nuk deshe te qendrojsh si idealistat e mbdhaj te botes, ti atehere qendro si stergjyshnit tone ilirë, te cilet husarojshin neper ket det, pa frike, fitojshin buken si burra te lire dhe vdisshin si burra te lire ne ket det, por nuk e shajshin, si e shave ti pare, kur ishim siper. – Jo asht anekdode qe e kam ndegjue – m'u pergjigj shoku.
- Autori i se ciles je ti vete. Por e pagove.

Kanga e qytetit te huej

Kanga e qytetit te huej asht kanga e jetes qe rrohet. E jeta rohet, keshtu thote kanga: O njeri qe vjen nga dheu i huej, hiqe melankoline, ose nostalgjine per vendin tend – nese e ke, - ze vend ne nje skaj ne kryqezimin e udheve dhe vre levizjen e terbueme, qe shkaktojne pasionet njerzore.

-O dritat e bukura te qytetit te huej!

-Dritat e bukura... kuq, blu, jeshile, e verdhe. Secila drite nje grishje. Sinema, kabare, kafe, tregtiza. Te gjitha jane per plotesimin e deshirave tueja. U shembellejne luleve kah hyjne bletet, thithin nektarin dhe dalin te dehuna nga ambelsina e jetes. Ambelsinen, ambelsinen e jetes kerko ta gjesh se e hidhuna e jetes vjen vete. Prandaj jane dritat me ngjyra qe ta kujtojne: mos harro ta shijosh ambelsinen e jetes!

Prandej dhe ngasin keta njerez. Prandaj vrapojne keto makina. Prandej uturijne keshtu tramet. Dhe te gjitha keto ngjajne me nje tempo te shpejte, e cila te kujton se sa e shkurter asht jeta.

Posht, nalt, djathtas e majtas ngajne rrugat e drejta te pagabueshme si n’imagjinaten e nje inxhinieri te larëzum ne qiell(!).

Historia e njenës nga ato

Kush nuk e kujton? Kush e kujton, or shok, ate? Ke? Cilen? Cilen? - Ate! Njenën nga ato! - Po cila asht njena nga ato? Ato jan shume! Cili i ri (ose plak) nuk njef se paku dhete nga ato?! Pse ato jane shume. Pse shume ka meshkuj, shume ka pare, prandaj duhet ne numer relativ te kene dhe trupna qe shiten... Pra, kush asht njajo njena nga ato?

- Lulja, Lukja ! A s'e kujtoni Luken? S'e besoj... shtiheni... Apo ndoshta do mohoni dhe se e njihni? Me falni, por ketu nuk shkon ajo e famshme: kush guxon - fiton! Kjo shkon ngjeti! Do mohoni dhe se e njihni Luken? Me pretekst se jeni te ndershem... Te mos kini, te mos kini frige se nuk do ju quej te pandershem. Por ju, se paku, me siguri do njihni ndonjenen nga motrat legjitime te Lukes, asht njesoj si me njofte Luken vete. Jeta e tyne asht nje. Te gjitha jane njesoj dhe te gjitha ju apin ate qe kerkoni - me pare ne dore.

E Lukja e mire, Lukja e mshireplote - se ajo ishte njelloj hyjneshe - Lukja e deshrueme me te vertete askujt nuk i thoshte jo. Vijshin studentat, jo me ndoj qellim te keq, vijshin vetem me percjelle ndoj shok i cili gjithashtu ishte student. Kur kryente pune me te parin, Lukja i thoshte tjetrit: sa leke ke ne xhep? - Kater. - Hajde, - i thoshte te dytit, te tretit e te katertit me radhe dhe i çonte n'ode te saj. E pra, taksa e saj ishte tre frange. Por Lukja ishte ma shpirtmire, ma humanitare se shum vete te cilve ashtu i duhet me qene.

Se pari studentat, me te hymen mbrenda, kuqeshin, por kur vijshin per se dyti, para se te hyjne shikojshin djathtas e majtas mos t'i shofi kush, dhe mandej shpejt neper dere fut brenda si plumb pushke. Lukja kanjehere merrte poze serioze dhe u bertiste: - Pse keni ardhe? Ke kerkoni? Nuk asht ketu ai qe kerkoni...

Studentat hutoheshin, iu merrte fjala ne goje, shikojshin shoqi-shoqin, skuqeshin ne ftyre dhe niseshin te kthehen. Atehere Lukja plaste gazit, qeshej me gjithe zemer dhe i merrte per dore n'ode te saj. Kanjehere ziheshej me ta, pse ndonjeni nga ata ia puthte krahun e zhveshun, e kapte ose e ledhatonte per ftyre, ashtu si ka te drejte te kapi gruen e vet vetem burri qe ka vue kunore te prifti ose te hoxha, atehere Lukja i thoshte:

- Mos luej, more vagabond! Rri urte, - dhe ia kersite shuplake ftyres. Djaloshi nuk tundej, qeshej dhe mundohej t'ia kapi doren. Kur keta

vonoheshin ne kafe ne bashkefjalim e siper, ajo u thoshte te gjithve: ikni se po iu vine babat ose kanjihere i thoshte vetem ma te riut:
- Shko, se asht bame vone... Tash asht kohe me t'ardhe yt ate.
Ne keto fjale plaste gazi e rralle ngjante qe t'idhnohej djali tue thane:
- Baba i em asht i ndershem, nuk asht si une...
Atehere shoket dhe Lukja vete qesheshin ma me zemer per trashamansine, idiotizmen e shokut.
Ndonjeni per tallje e pyete Luken:
- Luke, ku e ke, pash zotin, xhybleten?
- Hajde me e pa ne dhome...
- Me gjith qejf...
- Po a ke tre frange?
- Po, kam tre leke...
- Hik, more zog... me tre leke do me pa Ameriken...
Por thash se Lukja ishte ma humanitare se ata te cilve u duhet ashtu me qene. Ndoj te ri, qe s'e fitonte lekun vete, e pranonte edhe me tre leke, natyrisht kur kish nge.
Rreth emnit Luke, vecanerisht rreth trupit te saj, ishte krijue njefare aureole(nimbusi) si rreth krenave te shejtenve. Aq sa ndonjenit i vinte dhe keq qe e quejne kurve, dhe mundoheshin ta zbusin kuptimin e fjales tue i thane prostitute, grue publike,grue problematike - me emna te cilet i kishin gjete tue lexue libra. Sidomos njenit, i cili nuk shqiptonte kurr fjale te ndyeta, i vinte keq ta quejshin Luken kurve. Vete ai le qe s'e quente kurr, por edhe kur thoshte kush, atij i dhimbste veshi sikur gerdhishte dikush sahanin me maje te pirunit. Fjala kurve ishte per te nje disonance e vrazhde ne melodine harmonike qe premtonte Lukja. Me e quejte Luken kurve, i dukej njesoj si me e quejte priftin grue pse ka veshe ragjen (veladonin). Ai edhe e perhapi nder shkoje fjalen prostitute.
Sentimentalizma e te rijve per Luken shkone edhe ma thelle; shpeshhere rrifeshin shoq me shoq vetem e vetem per hatrin e saj.
Prodhon nana - toke, prodhon krijesa me shpirt dhe pa shpirt, prodhon dhe krijon si me miliona vjet dhe me sekonda, prodhon trajta te cilat ngrofen njena me tjetren per me prodhue prap trajta te tjera e te reja per te vazhdue jeten. Dhe e njejte asht: si deshira e nje krymbi dhe deshira e njeriut. Me prodhue. Vetem se krymbi s'e din se prodhon, s'e ka ndergjegjen e prodhimit, e njeriu po, e din, e kupton, e ndjen bashke me energjite qe treten, te cilat duhet te treten. Dhe ketu, vetem ketu, jo ne

ndoj naltesim tjeter imagjinues te njeriut por ne ndergjegjen e krijimit qendron ndryshimi ne mes te krymbit dhe te njeriut. Krymbi krijon, ban punen e vet te krymbit (bren drunin) dhe vazhdon rodin; njeriu krijon, prodhon vepra teknike, artitekture, arti, letersie njesoj si prodhon dhe rodin e vet njerzuer. Jane energjite qe duhen trete simbas zotsis te çdo njeriu, energjite qe burojne te gjitha nga nje burim.
Melankolia, mendimi, shum here nervoza, jane efektet e energjis se grumbullueme, e cila s'ka se ku te shfreje. Dhe fantazia e te rijve krijon aureole shejtensh rreth trupit te nje grueje qe shitet, e cila, instinktin prodhues e ka lidhe me interesa materiale, pse shoqnia, drejt ose zhdrejt, e detyroi.
E ne dhomen e Lukes treteshin energjite e te rijve. Te mos u tretshin aty, do treteshin ngjeti, ne menyre te panatyrshme, te rafinueme, te shpikun vetvetiu, tue u bashku intelekti me epsh.
- Luke, keshtu-keshtu... Sa te bukur i ke syt..., - i fliste djaloshi.
Ajo heshte.
- Sa te bukur e ke kete... kete... kete...
- Praj, more vagabond! Hajt, mbaroje punen per te cilen ke ardhe...
Nje kaperdisje n'intimitet ma te lakuriqet, marrje fryme e parregullt, kanjehere ndoj kafshim, ndoj afsh ose edhe ndoj shuplake per trup te lakuriqet...
Kanjehere dhe Luken e zente nje trishtim i pakufishem. I dhimbste ajo gja qe e quejme shpirt, por vetem kanjehere, pse po t'i dhimbste me shpesh zotnia do ta qite jashte, pse Lukja atehere ne ato çaste te rralla thente gota, çinia, pasqyra, dhe çka t'i vinte per dore. N'ato çaste as nuk pranonte vizita. Ndoshta i dhimbste shpirti Lukes, pse te gjitha energjite e djemve neper te shkojshin kot? Ndoshta dhe ajo donte qe te prodhoje, si prodhon nana - toke dhe çdo krijese tjeter? O sa trishtim, puthuej dhimbe fizike ndiente, kur u kujtonte se asht nje grue qe nuk prodhon. Nje kukull, nje loder me pase per t'ia kushtue dhe harrue gjithe ato oret e mbrapshta kur e shef te zhigatun ne balte.

"Matane Gardhit Asgja Te Re"

Nje vransine si plumbi pushonte mbi qytetin gjithe diten. Jeta zhvillohej e ngathte, disi zvarrisej. Gjethet e para te vjeshtes keputeshin nga dega, zig-zag e bajshin udhen neper ajr e sa perkitshin token si me thane: qe, ketu asht vendi yne. Por, aty para muzgut, pa drite, fryni nje ere e rrepte. U shkrepen shamat nder dritore dhe dyert e nje lagjes mbare; gjethet si te terbueme fluturojshin ne te gjitha anet, derisa ma ne fund u qetsojshin ne ndoj qoshe. E n'oborr, mbas shtepis te Selim Mesit teshat e lame, qe gjithe diten shtri nu u teren, tashti filluan te valeviten, te rrahen, te fluturojne, te shkrahen neper toke bashke me gjethe. Nje grue e re tue nga e tue ba potere te madhe me ndalla, del jashte e mbasj saj, ngadale, nje plake. Shpejt fillojne me mbledhe teshat. Kur e reja, tue mbledhe teshat, mbrrin te gardhi qe ndan dy oborret e dy shtepiave, ndalet, veshtron matane gardhit nje cope here, e kur mbrrin plaka, i thote me za t'ulte: s'degjohet gja!... dhe mbasi kaloi stuhia, e reja thoshte qe t'i lane teshat dhe ma n'oborr.

E matane gardhit asgja te re. Vetem qe nje rreze dielli, e cila kish depertue rete dhe si shifet tue mos gjete vend ma te mire ne bote, kish ra ne pleh. Nje gjel, te cilin e kish zane gjumi mbi pleh, u zgjue dhe ia tha kikirikuuun gjate e tingellueshem.

- Plaç, he dreq, se me trembe! - peshperiti plaka e cila ish vue me veshtrime matane gardhin e nuk e shifte gjelin aty afer, mbas gardhit.

Në kishë

Në qytet tonë asht një lagje... E n’at lagje asht kishë. Mbrenda në kishë asht një lyps, në të cilin jeton një dëshirë: me jetue.

"Eni tek unë ju të dëbuemët dhe të përbuzunit e këtij shekulli, - ka thanë dikur zot’ i kësaj kishe, - se tek unë do të gjeni prehje...".

Lypsi ka ardhë. Dhe me të vërtet ka gjetë prehje. Lagshtina e kishës e fashiti të nxehtit e trupit të tij që gati e përvëloi.

Jashtë asht zheg. Dielli asht aq marrisht i nxehtë dhe aq egër të lëmon, saqë të rrahin tamthat, si të rrahunat e farkatarit mbi hekurin e kuqun.

Sa mund pati lypsi derisa mrrijti në kishë! Si për sherr, vapa s’e lente të eci ma shpejt. Kollaj mujshin dhe me e zanë. Por edhe vapa e shpëtoi. Se polici që e ndiqte ishte aq i shndoshët, saqë rrezikonte veten të shkrihet si dhjami në fultere, po qe se vazhdonte ndjekjen. "T’i hajë dreqi ata pes’ a gjashtë lekë, për të cilët u dyshue në lypsin! - mendonte polici. T’i hajë dreqi! Ndoshta dhe lypsi nuk i ka marrë." Por lypsi nuk donte ta përgënjeshtrojë at dyshim. Jo për gja tjetër, por pse, si njeri i ndershëm, nuk ka qejf të dali para gjyqit. Ka të drejtë! A nuk bajn njashtu dhe tregtarët e parë të qytetit tonë? - E kush mund ts dyshojë në nderen e tyne? Me dalë para gjyqit edhe si i pafajshëm - asht turp në sy të popullit tonë.

E lypsi në kishë... Rrin në bankë dhe kënaqet në freski. Oh sa mirë asht me ndejë, me u shplodhë e me qenë i siguruem me bukë për dy ditë... Gjashtë lekë! Edhe tri ditë mund të kalosh me gjashtë lekë. Një, dy, tre, katër, pesë, gjashtë lekë. Tik-tik-tik-tik! Një frat, në thellsi të shejtë mbas lterit, trazohet me këtë tingllim monedhe. E qet kryet mbrapa shtatores së një shejti. Por asgja! Shef vetëm një lyps, i cili me shuplaka të njituna i lutej zotit. Edhe lypsi, i hutuem, shikon kryet e padres. Frigsohet. Gadi asht të besojë se po ngjet ndoj mrekulli. Por jo. Ishte kryet e padres. U diktue. Kur u zhduk kryet, lypsi vazhdoi t’i lëmojë gjashtë lekët dhe t’andrrojë ma tepër dhe të knaqet ma tepër se tradhtari Iskariot me tridhetë q’i fitoi, kurse e shiti Mësuesin e vet dhe t’atij padres.

Dalngadalë, n’andrrim e sipër, lypsin e zu gjumi në bankën e mbrapme të kishës, - gjumi i tij ishte i qetë, si gjumi i njerzve pa kujdese jete.

Qetësia e kishës filloi të trazohet... kapela të kuqe e të zeza, petka të bardha e të kaltërta, çarapë të mëndafshtë e pambuku, fytyra me mustakë dhe pa mustakë, të qeshuna e të ngërdheshuna - besnikët vijnë të ndëgjojnë oratorin e mbasdrekes. Bankat janë mbushë. Dhe në bankën e mbrame asht lypsi.

"Vërtet, me të vërtetë po ju tham, - bumbullon padreja prej së nalti dhe shi e breshën e lëshon mbi mkatarët. Të gjithë besnikët i kanë la dhe dlirë veshët e ndëgjojnë fare mirë. Pleqt kanë hapun gojën. Një plakë qeshet simbolikisht. Dy të reja grinden me shejat e duerve: "A asht rrue padreja sot, a dje?" Një vajzë knaqet me rreze t’ylberta që kanë ra në zhgun të padres tue përshkue nëpër dritoret bojna-bojna... Dhe oratoria shkon krejt mirë. Por kur padreja filloi t’u kërcnohej atyne që vjedhin, dhe n’atë mënyrë e preku n’intimitet lypsin, ky u çue, duel jashtë, e te dera, mbasi plot mni e nderoi padren, me një të shame, pëshpriti: "Po si do të jetoj unë?... këtë kurr s’ma the. E unë, pra, due të jetoj!"

SOKRAT I VUEJTUN –APO DERR I KNAQUN?

Prozë

Alternativë

Një alternativë me dy ftyra, siç janë të gjitha alternativat.
Tue u krue mbas veshi rrin njeriu para alternativës, dy ftyra,- mbrapa një ftyrës asht Sokrati i vuejtun me rropatmet e veta e mbrapa së dytës ftyrë asht derri i kënaqun me trup të rrumbullakët të vetin. Te Sokrati nuk ke çka shef: Dy sy të tretun në rrashtë, disa shkarravina të pa lexueshme dhe një trup me do gjymtyrë të zhgatrrueme e pa asnjë vijë harmonike; e te derri ke çka shef; at forcë të kombinueme mbas rregullave strikt estetike,- e sidomos që ta knaq synin- aj trup, i majun e i shndoshë e me andje t'zhigatuni, dhe më në fund aj bisht i përclluem në flakën e bukurisë hyjnore.
Rri njeriu përpara kësaj alternative tue u krue gjithnjë mbas veshi, ku e ha dyshimi- se nuk di se ç'ftyrë të zgjedhi. Por, falemi perendisë! Praktik ashtu siç e ka dhanë natyra, në fund–fundit njeriu dijti me zgjedhë. Edhe dijti me zgjedhë fare mirë; aq mirë sa edhe krijesat e planetave të tjerë, dhe ma të përparuem se njeriu, ia patën lakmi.
Vetë Perëndija, tue i ra kokës me dorë , tha se nxansi e kaloj mësuesin, dhe shumë-shumë u pendue se ç'shkathtsi i dha njeriut.
Njeriut ju shtue vullneti për t'u praktikue në shkathtsi.-E dikush dikur tha: „Nuk mundet me kënë shërbëtori ma i madh se zotnija i tij, as nxansi ma i mdh se mësuesi i tij".
O vall! Ç'ironi groteske!
Por a dini se ku qëndron eureka (e gjeta!) e njeriut?
Ç'bani njeriu me alternativën? –(Ha fort'e qerrata duel njeriu). Sokrati kurrsesi nuk ju pëlqente, -por as derr nuk mund t'u bante që ta merrte ftyrën e tjë. Derr! Vërtet se asht i lakmueshëm derri, por sado kudo, do të ruhet dinjiteti njerzuer përpara botës-edhe pse mikroskopike në pikpamje të tolerancës morale. Atëhere, në këtë pezullim të njeriut, u zgjue në të, ajo gja që nuk asht prej ksaj bote, ajo gja send q'i thonë pjesa qiellore, hyjnore, perendore e ku dij ma…u zgjue -dhe njeriu u ba batakçi. Ndrroj ftyrat; ftyrën e derrit ja vu Sokratit, e ftyrën e Sokratit ja vu derrit e në këtë të mbramën u mishnue vetë. Muer ftyrën e Sokratit të vuejtun -por

vetëm ftyrën -e pjesën e mbrame ja muer krejt derrit. De jure u ba Sokrat -e de facto ishte derr. Mbet Sokrat i vuejtun me ftyrën e derrit-dhe mbet të vuej edhe mbas vdekjes së vet. (Edhe ktu asht tragjedija e Sokratistvet -dhe nji arsye se njeriu zgjodhi të bahet derr). E njeriut-Posë në skenë-nuk ja ka anda tragjedinë. Thashë se –« de iure u ba njeriu Sokrat », por « de facto » u ba derr. Krijesat nuk mund ta njofin se asht derr dhe e nderojnë si një Sokrat. Por ka nji herë njeriu nuk mundet ti mshehi cilsinat e derrit dhe na paraqitet ashtu siç asht.
Kështu njeriu kalon nëpër shekuj. Në vënd që të naltsohet ndër sfera të kullueta e të shklasi prej hyllit në hyll me hapa përparimi, -njeriu poshtnohet e bahet derr dhe Sokratin e dëbon të fyem, tue ja vu maskën e derrit.
Qashtu njeriu ja luejti lojën… kujt ?... vehtes ! vehtes !
-bërtet morali prej mërgimit,

Shenime: Torino – Sanatorium, San Luigji

Me 15 Maj 1938 – ka kohe qe me sillet nder tru mendimi te marr shenime ne shtepine e te deshpruemve – ne sanatorium. Sot, ma teper se kurr, m'asht duke kjo banese shtepi e te deshpruemve, mbasi nuk ndihesha mire fizikisht, e kur nuk ndihem mire fizikisht, vuej dy here ma teper shpirtnisht.

Mbasi e diela – erdhen Olga, Arta T. Dhe Ankthim K.* Biseduam mbi temen e dites: politiken, mandej mbi mizat e ngordhuna neper toke nga formalina. Ne korriz te politikes se dites dhe ne korriz te mizave te ngordhuna e bame pak gaz (humor). Kur shkuen keta, ndihesha ma mire dhe ne darke ngrana mjaft mire.

** Olga Nikolla, motra e Migjenit, Arta Taçi (Franja) dhe Ankthim Konomi, studente ne Universitetin e Torinos ne vitet 1934 – 1939.*

TE FALA NGA FSHATI

(Leter mikut te tij Teufik nga Migjeni)

I dashtun T.*

Si dikur murgjit e krishtenë nëpër shkretina dhe shpella vetmitare, që u futshin thellë në ego të vet për të pa zotin e mrekullina e për të ba mrekullina – qashtu unë, në këthough fshat, zhytem në veten teme, fundosem në një subjektivizëm më t'ekstremtë – por jo për të pa zotin e mrekullina; as për të ba pëlqyeshme për mue – s'kam ç'të baj ndër shëtinat e mbramjes nëpër këto fusha të shkreta (ndoshta dhe jo të shkreta, por të plota, një botë e pakuptueshme për mue!). Shëtis, shëtis i ngadaltë, mandej të shpejtë, mandaj ma të shpejtë, derisa ndonj ferrë e ngatrrueme për kambët e mia më sjell vërejtjen: hej! ma ngadalë... ka je nisë? Unë atëherë filloj një drejtim tjetër shëtitje dhe një drejtim tjetër mendimesh, fare pa kompas, e me një orientacion spontan. E mendimet e mia atëherë nuk janë mendimet e një njeriu që asht i kënaqun me jetën, por janë mendimet e një njeriu që vuen. Vuej bashkë me fëminë, të cilit prindi nuk ia bleu lojnën, vuej bashkë me të riun që digjet n'erotizëm, vuej me pesdhetvjeçarin që mbytet n'apatinë e jetës, vuej me plakun që dridhet nga friga e vdekjes; vuej me bujkun që lufton me tokë, vuej me puntorin të cilin hekuri e ndrydh, vuej me të sëmundët e të gjithë sëmundjeve të krejt botës, por nuk vuej me këthough mizë, së cilës gjithnjë dallndysha i kërcnohet e për motrën e së cilës tha një plakë : Gjynah, asht kenës i zotit. Vuej me njeriun! E besoj, i dashtuni T., se nuk asht kjo një metamorfozë egoizme, - siç pretendojne disa, - por asht diçka tjetër që shpallet te njerzit, të cilët – rastësisht, për një kohë – gjenden jashtë materializmit t'ashpër. T'idhta këto mendime më therin ndër ndjenja dhe më pezmatojnë. Do të thuesh, T., se jam pesimist i pashëruem, se më ka tërheqë Shopenhaueri me stilin e vet të bukur... Jo? – admiroj stilin e Shopenhauerit, por ndjenjat dhe mendimet e tij, për veten teme janë vetëm fusha ku lexuesi mundet me shijue gjithe atë bukuri stili, pra nuk jam shopenhauerist – pesimist nuk jam, se besoj në një fuqi të njeriut, besoj në mbinjeriun! (Tue mendue kështu, në vesh më tingëllojnë fjalët e dikujt: "Besimi yt të shpëtoi!"). Po pate dhe ti këso mendimesh po të

rekomandoj këtë besim, ma madern dhe ma të përshtatshëm të kohës soçme – besimin në mbinjeriun!
Tue ndjekë shëtinë, marr drejtimin kah jugu, ka një largësi 7-8 km shof Shkodrën, të mshtjellun në një tym të kaltër. Sa dëshira të flakta ushqej për këtë qytet! Dëshirat e mia janë shumë – shumë ma të sinqerta e ma të mëdhanja se dëshira që pat perëndia kurse krijoi botën. Shkodra, dashunorja e shekujve! Shkodra, Shkodra, dashunorja e qiellit të kaltër! Shkodra, Shkodra, dashunorja e maleve të hjedhta, lumenjve të cemtë e liqenit andërrtar, në të cilin – në mëngjese të kullueta – lan hijen e vet. Shkodra një atitude shprehjeje... një fjale e cila përmban gjith nostalgjinë e ditëve të fikuna. Këtu në këtë largësi, ndiej damarët e saj që rrahin, rrahin e rrahin... edhe, sikur mjeku që tharpton ftyrën n'idhnim, tue pa se pulsi i dashnores seme nuk rreh siç duhet. Rreh: dy herë, një herë, pesë herë, dy herë, tetë herë, dhjetë herë, tridhet herë në sekondë! Pushon përsëri: një herë, katër herë, gjysëm herë! Tue rreshtue këto të rrahuna fshana: pse nuk jam një pontifeks maximus, një papë ose një patrik të hudhi mallkimin e plotë, t'anatemizoj sëmundjen epidemike bashkë me shkaktarin e saj! Por, me habi syt më ndjekshin një dallndyshë, e cila, për të zanë sa ma shumë miza, stërhollonte gjithfarë lëvizjesh, akrobatike tue rrëshqitë nëpër ajër, e mue më shkoi mendja se Shkodra, Ballkani, Europa, Bota mbarë asht sëmurë prej këti akrobacioni dallndyshuer. Besova se dhe kjo dallndyshë do thejë qafën në këto akrobacione, por atë e kish falë perëndia ma të shkathtë për jetë: pa psue asnjë dhimbje kreje, u ngop me miza!
Sjellem nga perëndimi, shkas barin e njomë; e do mendime plot sarkazmë, t'idhta më turbullojnë kryet. Përqark, natyra në gjelbërim më ngjan si një koketë e burdelit, e veshun në një dekolte pikante. Liqeni me prralla të marra të "Një mijë e një natës", malet me një heshtje qesharake, e mbi këto dielli i vjetër, dielli një mijë, pesë mijë, dhetë mijë e kushedi sa vjet i motçëm. Jo, jo, dielli, nuk pajtohem me ty, pajtohem me të që ushqej tashti asht dëshira me ju ngërdheshë, me iu dëftue gjuhën këtij dielli, që aq indiferent prendon prapa maleve.
Nisem kah shtëpiat e fshatit, i cili asht në masmarrëveshje të plotë me qiellin. Për mbramen herë shof Shkodrën, i dëshroj "natën e mirë" dhe i dërgoj një të puthun n'ajër.

Shumë të fala
M.

Teufik i dashtun.

Te shkruej! - por çka... Ta kam premtue, ne rast se nuk vij, ta shkruej nje leter, - por me çfare permbajtjeje? Nuk kemi pase fjalen. Shkurt: ta kam premtue letren e une nuk do dij mbi çka te shkruej, andej rrjedh silogjizmi hipotetik: po deshta te shkruej me e majte fjalen, e jo si "dikush" - me duhet te shkruej marrina, ose: po deshte mos te shkruej marrina - qe mos te kompromentohem, hem-hem - me duket te praj, te perfundoj letren. Por jo! Jam per silogjizmin e pare: te shkruej, te shkruej marrina - te kompromentohem.

***

Teufik, çka ashte kjo fjale, ky verb me u kompromentue?
Shpeshhere ia thojme shoqi-shoqit, kinse me sinqeritet - "mos te kompromentohesh!" Njeriu ia thote vedit, mos te kompromentohem!!! Gruaja, ne rruge, nuk shikon as djathtas as majtas, - as kenin - mos te kompromentohet: po ai terhoqi syte simpatikisht subjektit reciprok, e lan vedin me fjale: "pse jane syte?, mandej nuk se shikova shume qe te kompromentohem" - dhe keshtu kompрometohet dyheresh: kur shikojti dhe kur desh te laje vedin. Edhe ne mue, ne ndergjegjen, d.m.th ne hijen e mendimit -endet ky verb: me (u) kompromentue, endet edhe shume. E une s'e dij pse me sulmon kaq shpesh? Ndoshta e drue, ose jam flia e tij? Por argumentet, me cilet arsyetoj para vetes teme, nuk me lane me mendue se e drue kete verb, ose jam flia e tij. Per veten teme, ky duhet meshi fare prej gjuhes, ose do te ruhet nden ndoj kuptim tjeter, si e ka per shembull fjala nje rraje me ket verb "comprom" - d.m.th nje te dalun (si prej ngatrresave, sidomos politiken morale). E verbin, me kuptim, si e merr bota shqiptare duhet me e debue. Me u kompromentue me fonetike tjeter, d.m.th me shpalle sinqeritetin: kur thote ndokush: Mos te kompromentohesh - ai thote: mos trego sinqeritet, me fjale te tjera: rrej! Epo athere a asht e arsyeshme ta majme ket verb? - Jo! Njeri mondan, comme il faut, si e lyp koha - duhet ta debojme! Mos ec si ta do natyra, por ec si duhet, mos te kompromentohesh: mos fol si ta do natyra, por fol si duhet, mos te kompromentohesh: mos u sjell si ta do temperamenti, por sjellu si duhet, mos te kompromentohesh: mos u shpreh kurre me sinqeritet, por me rezerve, mos te kompromentohesh - dhe keshtu gjith

jeta e njeriut, nder imitacione: e pra shume vet thone se njeriu nuk rrjedh prej majmunit - qe t'imitojn kaq shume.
Por mjaft, mjaft mendime serioze e te marra deshta me than... Si te ngjajne ty, Teufik?
Neser... Ah, neser... por nejse... Shikoje edhe per mue ate q'i ka floket ne harmoni me sy.
Ortografia e ë ka filluar me m'u zbe.
"Allahile" mos lexo ne vend hira-bira. O si me marrove at dite, more i pahajr!
Mbrenda kesaj javes pres letren tande.
Po ta dergoj novelen; po s'mujte me e kendue - lene kur te bashkona.

Te fala
Milloshi

Urime per 1937

Shok i dashtun, une pergjithesisht nuk shkruej urime, as per Krishtlindje as per Bajram, as per ditelindje as per ndoj feste tjeter. Nuk shkruej, pse urimet qe n'ato dite tan bota ban, nuk dij a plotesohen nje per qind se pothuej te gjitha dalin nga hipokrizia. Bota kete e din, por njesoj vazhdon te shkrueje urime. As per Motmotin e Ri deri tash nuk i urova askujt asgja. Por kesaj here due te hyj ne rradhen e njerezve korrekte dhe t'u uroj shokve te mi Motmotin e Ri 1937.

Se pari, t'uroj, shok i dashtun gjumin e ambel, qe te mos ndegjosh si gjemojne njerezit nen barren e kryqave te vet tue mundunve, as britmen e ngadhnjysve ne kete jete. Te mos ndegjosh bumbullimen e Spanjes. Gjumin e ambel! Te mos ndegjosh si afer teje gerset dhemballa per dhemballe, nga te ftohtit. Pse atehere duhet te pyesesh: moj dhemballe, pse ndeshe per dhemballe dhe gerset aq? E gjuha ne vend te dhemballes pergjegjet: pse asht ftohte, zotni, e kur asht ftohte, zotni, u hyn dreqi trupit, muskulave, nervave, zotni, dhe qashtu gerset dhemballa per dhemballe, zotni. Asht teper banale te themi se mungon veshja dhe mbathja dhe zjarrmi, prandej: gjumin e ambel, shok i dashtun.

Se dyti mbas gjumit t'ambel, t'uroj - ç'asht dhe e natyrshme - te jesh i gezuem, gjithmone i gezuem. Nga gezimi i madh, ne sentimentalizem, te puthish drrasat e dhomes e shtyllat, si bani Greta Garbo ne filmin "Mbretnesha Kristina", kur shijoi dashunin shtazore (desha te them hyjnore, por njesoj asht). Aq i gezuem, saqe bota te ta kene zili dhe te thone: oh, sa i lumtun asht! Te jesh i gezuem edhe pse n'ane tjeter zemra te pelset, si paljaços. Te jesh i gezuem, se gezimi yt u jep shpresa edhe tjerve. Ne rase se tryeza e shkrimit te çalon, ti qeshu. Ne rase se e vetmja karrige qe ke ne shtepi asht e shpueme dhe s'ke se ku te rrish, ti qeshu. Ne rast se s'ke zjarrm e ke te ftohte, po, ti qeshu. Ne rase se ndonj dite, ashtu kot, te mungon dhe buka, ti merre per loje, per shaka, dhe qeshu, qeshu. Del ne rruge bile, ne kryqzimin e udhve, dhe qeshu,qeshu,qeshu, e bota do ta kete zili dhe do te thote: ah, sa i lumtun asht! E kur te te vije ne shtepi ta shofi shkakun e gezimit tand, do t'i kujtohet botes vetvetja dhe do te filloje te qeshi kikikikakaka. Smundja e te qeshunit do te perhapet nder te gjithe dhe njerzit si majmunat do te hidhen perpjete nga gezimi... Dhe keshtu uroj qe vjetin 1937 ta kalojme

ne gezim, edhe se te smunde patalogjisht.

(shkruar ne Sanatorium, Torino.)

I dashtuni Teufik,

Dje e mora kartolinen tande. S'mbaj mend permtimin. Megjithate, kam dashte me te shkrue para disa ditve, por thash mos e trazo ne qetsin e tij dhe lene te fryhet.

Une me shendet nuk jam kene aq keq, por erdha ketu ne sanatorium per me mjekue hallin e vjeter. Tash nje dite me vizitoi "primariumi" dhe me tha qe ne ditt e para te qershorit mund te shkoj ne bjeshke. Domethene, punet i kam mire.

Ne ket sanatorium asht pak merzi dhe s'ka ambient divertues per mue. Dhe ne gjuhe nuk jam tue perfitue shume, mbasi flasin ne dialektin pijemontez. Per mue, i vetmi kalim kohe asht leximi. Jam tue kendue veprat e Emil Ludwig - asht biografist me fame. Kam kendue "Napoleonin" e tij, tashti jam tue kendue "Goethe" - jane vllime te medha.

Nse don me dite gja per Torinon... Torino asht Torino.

Te ke gabue qe, tue dite pake a shume italishten, nuk ke ardhe kendejpari. Mesohet diçka nga nje bote krejt tjeter e bukur. (Me mesue, thash, e jo me simpatizue - te mos kuptosh keq). Nsa shkruej keshtu, une te kam parasysh ty e jo Elez(in)...

Pothuaj tash dy muej asht tue na mbajte nje kohe shume e bukur. Mos t'isha ndrye ne kete sanatorium si "kara gege"***, do t'i shijojshe bukurinat e Torinos pranveruer prane lumit PO. Megjithate, me leje mund te dal, por sa para ban per nje ose dy dite.

Nuk jam konden me kartolinen e jote. Pres leter nga ti tjera here. Se ti mund t'i dijsh mire te rejat e te vjetrat e Shkodres-loce.

"Vllaznia" apo tregohet dinamike?

Te fala ty dhe shokve - Milloshi

*** *kara gege - aluzion per Mahmut Pashe Bushatin, i denuar nga sulltani me vdekje dhe i rrethuar ne kalane e Shkodres(A.C.)*

Te dashtun Lenka dhe Lazer! *

Kam vendosur te fryhem, prandaj kam hyre ne kete sanatorium. Mos mendoni aspak per mua, une jam si gjithmone: vetem se ketu ne sanatorium po e ndjej se po shendoshem, per njembedhjete dite kam shtuar 1.5 kg; domethene ne nje muaj mund te shtoj 4 kg dhe me teper. Prandaj mos u shqetesoni.

Ju do i Juaji MIRKO

Vido!

Matematiken pak me mire... pyet per çfare s'kupton, - te mos kesh turp.

Ju don daja Milloshi

** Lenka e motra e Migjenit, Lazeri i shoqi i Lenkes.*

Zotni Luarasi, *

Me pare desheroj qe t'Ju gjeje kjo leter te kenaqun ne çdo pikepamje - mbasi qe e dij mirfilli se ç'domethane i pakenaqun ne te gjitha pikepamjet.
E dyta - Une jam gati t'i leshoj ne shtyp kanget e mia. Tue qene se Ju, kur ishit ketu, me premtuet se do ta merrni persiper me fole me ndoj botonjes, si per shembull me Gutenbergun, une tashi po Ju kujtoj at gja tue Ju thane se jam gati. Dhe Ju pata thane se te holla nuk kam (kete Ju perserita qe ta dini te rregulloheni ne bashkefjalim me botonjesin). Vjersha jane 35 cope. Mbas mendimit tim, po qe se asht formati i librit 20x12 cm - si deshiroj une, - vjershat mund te shtypen ne 90 faqe. Kjo barre qe po Ju ngarkoj, asht e vetedesherueme nga ana e Juej e une do t'Ju jem mirenjohtes dhe ne rase mossuksesi ne kete pune. Por, Ju lutem, te me lajmeroni perfundimin e bashkefjalimit qe te dij te rregullohem.
Degjova se keni qene n'Austri, per çashtje... ma mire mos ta them, se ndoshta gabohem.
A kish ndryshue Vjena, o njerzet? Por besoj ma teper keni ndryshu Ju se Vjena.
Ju lutem per gjegje.

Shkodër, me 12. I. 1936

Te fala dhe nderime
M. Nikolla

Adresa: Millosh Nikolla
Shkolla "28 Nenduer"
SH.

P.S Po qe se takoheni me z.Llupin, shefin, Ju lutem t'i thoni se tashma nuk me duhet transferimi per Pukë.

** Letra i drejtohej Skender Luarasit, i cili u njoh me Migjenin ne vitin 1935, kur ishte mesues i letersise ne Gjimnazin e Shkodres.*

I dashtuni Lin,

Sot me ane te konsullates se ketushme, ia dergova lutjen Ministris s'Arsimit per leje tremujore. Me 15 te k.m* shkoj ne Sanatorium, i cili gjendet ne rrethet e Torinos, afer. Me bahet se te kam shkrue nje here se me kane thane mjeket se kam shume nevoje per kura; edhe une, natyrisht mbasi po m'epet mundesia, kam vendose me i ndegjue. Besoj se do te qendroj ketu ma se tre muej por tash nje here veprova ne baze te ligjit organik t'Arsimit.

Por puna qendron ngjeti. Me duhet me dite sa me pare kush po emnohet ne vend tem, per t'i shpjegue shume gjana, mbasi punet e Pukës, tue mendue se do te kthehem, i kam lane mjaft te nderlikueme. Prandaj edhe nje here te lutem, Lin, me njofto sa me pare kush do emnohet, mbasi dhe koha po avitet. Adresa e eme asht po ajo qe kishe, Della Rocca 10.

Te kam shkrue dhe nje leter ku te thosha mos me veprue gja me dokumenta (mbasi tash kam telashe tjera) dhe te kam pyete per rroge. Ti nuk me pergjegje, ndoshta ishe ne Tiranë nder keto dite?

Me bahet Lin, se vjetin 1938 s'e kam fillue per se mbari.

Me shkruej, te lutem.

Torino, me 12.II. 1938

Te fala

Milloshi

* *ketij muaji.*

E dashtuna Cvetka,*

Dje Olga(1) ma pruni lajmin mbi martesen e Llazarit(2). Jemi qeshe shume. Llazari me tha besa mue ne Shkodër kur ishte atje, por mendova se e ka per te qeshe dhe i thashe tue qeshe: nese ta qet hesapi pse jo? Dhe ai e paska pase perimend. Neve ketu s'na kane shkrue fare, prej Ujnes(3), megjithese une i kam shkrue qyshkur; gjithashtu i kam shkrue edhe Jovankes(4), por as ajo, s'na ka shkrue.

Une jam fare mire dhe nuk merzitem. Shume shqiptare vijne me më pa, njashtu qe mue e Olges s'na takon gati kurr me kene vetem dhe me bisedue. Vetem dje ajo erdhi ma heret dhe e kenduem letren e jote. Te gjithe keta qe vijne me më pa, me bijne koke, njashtu, qe une mezi qe mund t'i ha gjith ata sende.

Olga te ka lute per nje liber per te cillin i ka shkrue Mirko Kadiqit(5); une tash po te shkruej per nje tjeter per te cillin mundet me pyete Vidoja ne Stari Bar, e po qe se s'ka ne Stari Bar, atehere t'i lutet knjizarit qe ta porosisi ai vete, mandej ia shet Vidos, dhe mbasandej ma çoni ju mue. Libri thirret: "Neçista krëv"(6) od Borisllava Stankoviça. Ket pune bane kur t'i marresh pare qe i ke te Jovanka.

Torino, me 14.II. 1938

Tash ju perqafon te gjithe,
Milloshi

** Letra i drejtohet Cvetka Nikolles, motra e Milloshit.*
(1) Olga Nikolla, motra e Milloshit.
(2) Llazar Kokoshi, djali i dajes dhe bashkemoshatar i tij.
(3) Ujna - Darina Kokoshi, dajesha e Milloshit.
(4) Jovanka Perja, motra e Milloshit.
(5) Mirko Kadiqi, shok i Milloshit.
(6) "Gjak i papaster" - serbisht.

I dashtur Lazër,*

Kete here vendosa te te shkruaj vetem ty. Me shendet po perparoj.
Po me shkruan Cvetka se ke filluar qe tani te mendosh per Vidon. Une do te thoja se internati nuk eshte per Vidon, pas Vidoja meson vete me deshire, dhe jeta ne internatet e atjeshme nuk eshte shume e kendeshme: une e kam provuar kete shume mire. Me mire eshte per Vidon te hyje ne nje familje te mire private ne Cetinje ose ne Podgorice, sepse jane vende te shendetshme.
Per sa i perket burses, kam dyshim: por nuk eshte keq te beni lutjen, sepse nuk kushton gje. Por Vidoja nuk duhet te humbase kohen: vjeshten qe vjen ai duhet te vazhdoje klasen e peste. Sa per shpenzimet, do te bejme disi, mbasi nuk jane aq te medha. Por ka kohe akoma qe te mendojme per kete. Ne qofte se Vidoja do te mbaroje semimaturen si nxenes shume i mire, atehere le te kerkoje burse permes gjimnazit; le ta provoje.
Pasi Olga ju ka shkruar mjaft, une po e perfundoj me kaq.

Ju do te gjitheve dhe ju pershendet Mirko.

** Kjo leter i drejtohej Llazar Jovanit, burrit te Lenkes, motres se madhe te Milloshit, te cilet jetuan ne Tivar. Te afermit e therrisnin Milloshin - Mirko. Vido eshte djali i Lenkes dhe i Llazarit.*

E dashtuna Cvetka,

Do te kete çudite letra e pare e emja, ku thoshte se po rri ne sanatorium: tashti po te shkruej bash prej sanatoriumit, ku kam ardhe tash 11 dite. Si ju kam shkrue edhe perpara, mos mendoni fare per mue, se ju e dini se une kam pase gjithmone qejf per me ardhe ne ndonje sanatorium, per me shtue ndoj kile. Edhe si shifet, ketu po me shkon mire puna, mbasi 11 dite kam shtue 1.5 kile, domethane mjaft mire.
Sanatoriumi asht afer Torinos dhe Olga vjen dy here ne jave per me më pa, dite -ejte dhe dite- dielle: me Olgen vijne edhe shume shqiptare te tjere qe gjinden ne Torino, njashtu qe nuk merzitem. Per sa kam me ndejte ketu nuk dihet. Ministrise i kam kerkue leje per tre muej. Ti mos u merzit. I kam shkrue ne Shkodër qe nga rroga e eme me te çue 1000 dinare: Jovanka ka me u mundue me t'i çue me ndokend, por interesohu dhe ti per at pune. Ndryshe nuk dime si me t'i çue.
Per teshat qe i kemi lane ne Pukë, mos mendo fare, mbasi ne Pukë eshte transferue Abdulla Canga dhe une i kam shkrue dhe e kam lute per me u kujdese. Per ato pune ai asht i vetmi. Tash i shkruej edhe Ejllit*. Per me shkue ti atje ato tesha per me rregullue, s'kane me te lane; mandej me u kthye Lenka, e ne Shkodër ke me u merzite se une do te rri ma teper se tre muej, ketu. Por ti, kur t'i marresh ato 1000 dinaret, shko tek Millani(1), s'ka gja me shkue te Leposava(2) edhe nje here.

Torino, me 27. II. 1938

Ju perqafon te gjithe Milloshi

** Ejlli - Engjell Kozmaqi, mik i Milloshit, punonjes i Poste ne Pukë*
(1) - (2) Millani dhe Leposava, femijet e Kristo Nikolles, xhaxhait te Migjenit, qe ne ate kohe jetonin ne Ulqin.

E dashtuna Cvetka,

Te djelen ma pruni Olga letren tande, por deri me sot nuk mujshe me t'u pergjegje, mbasi me kishte dale nje i thate "ogozag" dhe nuk mujshe me ndeje ne karrige. Sot m'u shendoshe.
Tash nje dite mora leter prej Abdullahut. Me shkruen se i ka vendose teshat ne oden mbrapa zjarrmit dhe i ka vue deren, njashtu qe nuk mund te hyjne femite. Thote se tlyni qe e ke lane ne qyp, s'ka me u prishe. Po ai i shkreti asht dasht me shkrue ne Mal i Zi, atje ne Pukë kane prue nje tjeter. Atij i ka ardhe shume keq, siç shihet, por s'ka si me ba.
Me ka shkrue Mehmeti dhe Ejlli. Mehmetin s'e kane transferue. Ka kujtue se je ti ne Shkodër dhe me ka shkrue se do me shkue me te pa. Une i kam deftue mandej. - Sonte bash kam pa anderr Ganimetin* tue luejte futboll.
Me ke pyete per inicione a me dhambin? - Nuk me dhambin se kam tul "ogazag" - edhe keto infermieret qe m'i bajne, keshtu me thone. Me drite tash e kam pune mire, se ka nje jave qe jam ne nje dhome me vedi, ku asht shume bukur dhe mundem naten me ndeze driten kongraband.
Fjel mire bile, as me lexue s'po mundem prej gjumit.
Si nuk i more ma ato pare? Une nuk mundem t'i shkruej Julkes(1) per at liber pa ia çue paret e une prej ktej s'kam se si ia çoj. Po njato zoja qe na shkrueve ti njehere a nuk shkuen ne Shkodër-a? A por paskan ba qejf me mend edhe Lenka me ta.
Po pate qejf, mire ban me shkue ne Podgorice, mund te kthejsh edhe ne Cetine, per nje dite a dy.
Po qe se shkon ti tash shpejt ne Podgorice apo Cetine - pyet per at liber qe ju kam shkrue ("Neçista kërv" te Borisllav Stankoviçit).

Torino, me 14. VI. 1938

Ju perqafoj te gjitheve
Milloshi

** Ganimeti - vajza e Bajram Currit. Milloshi u njoh me te ne Pukë, ku ajo vinte per verim se me nenen dhe motren e saj, Hajrie.*
(1) Julka Nikolla - vajza e Kristo Nikolles, xhaxhait te Milloshit. Jeton akoma ne moshen 86 vjeçare ne Zagreb.

E dashtuna Cvetka,

Ka 2-3 dite qe e morem letren tande, domethane edhe ti po shkoke ne Shkodër. Besa po drue mos te ndalin atje e mos te lane me u kthye ne Tivar. Ne ta bajshin njate pune, vete e ke fajin; mjaft te shkote vetem Lenka e kur te kthente Lenka, ti te shkojshe ne Podgorice. Por nejse, kur te mbrrije kjo leter, ti ke me kene e kthyeme ne Tivar, ose e mbetun ne Shkodër.
Ketu para 3 diteve bani nje i xete i madh, e tash asht tue rame shi. Une kesaj jave po nisem per bjeshke. Olga ka me ardhe ndoshta tek une mbas provimeve. Ajo asht e xanun tash tue studiue dhe s'ka me te shkrue. Kur te kthehesh nga Shkodra, na shkruej gjane e gjate mbi te gjitha.
Kesaj here s'po kam çka me ju shkrue, por te gjithve te fala.

Milloshi

E dashtuna Jovanka,

Ti ende nuk me ke pergjegje per letren teme, por une njesoj po te shkruej.

Me shendet jam mire, por duhet edhe mjaft kohe per me ndejt ketu, me u shendoshe mire. Une nuk merzitem, mjaft qe kam me dale njehere.

Si kane dal me nota gjelifanat? Si e kalojne me femite e mehalles, se aty jane mjaft dhe gjithfaresh?

Me vjen keq se aty s'kane aspak shoqni te mire, prej te cileve me mujte me xane gja te mire, por nejse.

Une ka do dite qe matem me shkue ne bjeshke, por ende nuk u nisa, por tash nuk asht tue bame gjithaq xete as ketu.

Mire qe e paske tash Ujnen pak me afer, per me mujte me shkue. Si e kalojne ata, si i kane femijet? Biserka dhe Tasi(1) a kane kalue klase? - Bani te fala.

Jovoja(2) ku punon tash?

A ju habitne ato prej Tivari?

Torino, 7.VII. 1938

Ju puth me femije

Milloshi

(1) Biserka dhe Tasi - femijet e Aleksander Kokoshit, dajes se Migjenit.

(2) Jovan Perja - i shoqi i Jovankes, motres se Migjenit.

Drejtuar askujt - vec vetes se tij.

Torino – Sanatorium, San Luigji

Me 15 Maj 1938 – ka kohe qe me sillet nder tru mendimi te marr shenime ne shtepine e te deshpruemve – ne sanatorium. Sot, ma teper se kurr, m'asht duke kjo banese shtepi e te deshpruemve, mbasi nuk ndihesha mire fizikisht, e kur nuk ndihem mire fizikisht, vuej dy here ma teper shpirtnisht.
Mbasi e diela – erdhen Olga, Arta T. Dhe Ankthim K.* Biseduam mbi temen e dites: politiken, mandej mbi mizat e ngordhuna neper toke nga formalina. Ne korriz te politikes se dites dhe ne korriz te mizave te ngordhuna e bame pak gaz (humor). Kur shkuen keta, ndihesha ma mire dhe ne darke ngrana mjaft mire.

** Olga Nikolla, motra e Migjenit, Arta Taçi (Franja) dhe Ankthim Konomi, studente ne Universitetin e Torinos ne vitet 1934 – 1939.*

Shenime: Peltje – “Zakonet dhe arti i revolucionit Francez”

“Arti… eshte nje nga format e shfaqjes se ndergjegjes shoqerore…Ne art ligjet e psikologjia e luftes se klasave shfaqen po aq qarte, “sa edhe ne fushat e tjera te ndergjegjes shoqerore. Konstruktivizmi (lef) ne parimet e veta kryesore eshte bashkimi i dy teorive krejtesisht te kunderta: i teorise se artit te “zbatueshem” nga njera ane, dhe nga ana tjeter e futurizmit borgjez. Megjithate, ne kohen tone ka njerez, te cilet, ne menyren me serioze, thone se arti dhe artisti jane te lire absolutisht, nuk varen as nga koha, as nga vendi dhe ambienti, nga klasa. E bile, dhe vete arti perhere eshte bartesi i ideve e pasqyre e jetes se kesaj ose asaj klase shoqerore, pasqyrimi i luftes se ketyre ose atyre klasave, dhe kjo eshte plotesisht e natyrshme, sepse artisti, si qenie e gjalle qe zhvillohet e ndryshohet, ushqehet me ushqim “shpirtnor” te atmospheres psikike qe e rrethon, po ashtu si, per shembull, çdo bime a kafshe ushqehet me ushqimin e ambientit fizik qe e rrethon. Dhe ja, si te jete kjo atmosfere psikike e ky ushqim, po ashtu eshte edhe pinjolli i saj – njeriu, artisti. Ashtu si ne format e medha te artit, po ashtu, sigurisht, edhe ne karikaturen gjejne pasqyrimin e vet te qarte gjithe etapat e zhvillimit te revolucionit. Pergjithesisht, arti i Revolucionit te madh ne gjithe deget e veta ishte shok e bashkudhetar besnik i perpjekjeve, i ideve dhe i veprave te klasave te kohes se vet. Arti eshte nje nga format e ndergjegjes shoqerore dhe, si i tille, ai eshte i lidhur ne menyre organike, plekset ne menyre organike me fushen politike te ndergjegjes shoqerore”.

Shenime: Hygo - "Te mjeret"

Pjesa I

Te mekatoje sa me pak qe te jete e mundur, ky eshte i ligj i njeriut…Te mos mekatoje fare, kjo eshte enderr e engjejve. Shpirti mbetet i mbytur ne erresire, dhe mekati behet ne erresire. Nuk eshte fajtor ai qe ben mekatin, po ai qe krijon erresiren (Peshkopi Bienveny). Ata qe grabiten per te ardhmen, rrotullohen rreth se sotshmes se shkelqyer. Kafshet nuk jane asgje tjeter, perveçse misherim i virtyteve dhe dobesive tona qe enden para syve tane, meshirime te dukshme te shpirtrave tona.
Ndergjegja eshte nje kaos pikesynimesh fantastike, deshirash, orvajtjesh fantastike, vater endrrash, shpelle prirjesh te turpshme; kjo eshte sketerre marresirash, kjo eshte shesh lufte pasionesh. Guret e çmuarshem gjenden vetem ne thellesirat e erreta te tokes; te vertetat gjenden vetem ne thellesirat e mendimit. Kur syri shef zi, shpirti shikon shqetesim(Kozeta).
Tempulli. Cfare kontemplacioni per mendjen e cfare mendimesh te pafund atje, ku reflektohet zoti ne murin njerezor!
Sistemi monakal, i mire ne fillim te qyteterimit, i dobishem per te frenuar brutalitetin e klerit, eshte i demshem ne kohen e pjekurise se popullit. Kur merr hov dhe hyn ne periudhen e çmendurise, duke vazhduar te jape gjithnje shembull, behet i pastertise se tij. Manastiret, te dobishme per edukimin e pare te qyteterimit modern, u bene pengese per rritjen e tij dhe te demshem per zhvillimin e tij. Edhe si institucion, edhe si mjet per formimin e njeriut, manastiret, te mira ne shekullin e dhjete, te diskutueshme ne shekullin e pesembedhjete, jane per t'u perbuzur ne shekullin e nentembedhjete. Manastiri katolik, ne kuptimin e vertete te kesaj fjale, eshte mbushur me rreze te zeza te vdekjes. Veti e se vertetes eshte puna, se ajo nuk e turperon kurre.
Te lidhesh me mend infinitin e larte (zotin) me infinitin e ulet (shpirtin), kjo quhet lutje. Kemi nje detyre: te punojme ne shpirtin e njeriut, te mbrojme misterin kunder mrekullise, te adhurojme te pakuptueshmen dhe te flakim absurditetin, te pranojme nga e pashpjegueshmja vetem te nevojshmen, te sherojme fene, t'i heqim religjionit bestytnine, te spastrojme zotin prej krimbave.

Pjesa IV

Krejt problemi i socializmit eshte: te prodhohet pasuria dhe te ndahet. E para permban çeshtjen e punes, e dyta permban çeshtjen e meditjes.

Pjesa V

Zemra jone eshte aq e frikshme dhe jeta e njeriut eshte nje mister i atille, saqe edhe pas nje vrasjeje politike, edhe pas nje vrasjeje çlirimtare, ne rast se ka te tilla, brerja e ndergjegjes se keni vrare nje njeri, ia kalon gezimit se i keni sherbyer races njerezore. Perparimi eshte jeta e vazhdueshme e popullit...

Ne shoqerine njerezore, siç eshte sot, derisa te mos e ndryshoje ndonje drite me e madhe, gjenden gjithmone dy njerez, njeri i larte dhe tjetri i nentokes; ai qe priret nga e mira eshte Abeli, ai qe priret nga e keqja eshte Kaini.

Shenime: Dostojevski – “Krim dhe ndeshkim”

Sipas bindjes se tij, dilte se erresimi i mendimit dhe dobesimi i vullnetit e kapin njeriun si nje semundje, zhvillohen pareshtur dhe arrijne momentin kulminant te tyre fill para kryerjes se krimit, vazhdojne dhe qendrojne ne po ate gjendje edhe ne vete çastin e krimit, dhe sa kohe pas tij, sipas natyres se individit perkates; pastaj kalojne po ashtu, siç kalon çdo semundje. Dhe problemin: nese semundja lind vete krimin, ose nese vete krimi, nga natyra e tij e posaçme percillet gjithmone nga diçka qe i ngjan semundjes – per kete problem nuk e ndiente veten akoma mjaft te forte per ta zgjidhur… me ate ndjenjen e çuditeshme te brendshme te kenaqesise qe vihet re edhe te njerzit me te aferm ne rast mjerimi te papritur, qe u ndodh te afermve, nga e cila ndjenje nuk ka shpetuar asnje njeri, pa perjashtim, edhe ne qofte se eshte frymezuar prej ndjenjes me te sinqerte te keqardhjes dhe ngushellimit.

Shenime: Shekspir – “Otello”

Ne e kemi ne dore te behemi te ketille ose te atille. Trupi yne eshte nje kopsht, dhe ne te shpirti yne eshte kopshtar... Arsyen e kemi per te freskuar ndjenjat tona teper te forta, eksitimet e mishit tone, pasionet tona te shfrenuara; dhe prej tyre perbehet, me duket mua, ajo, qe ti e quan dashuri, - ose mbajtesi i sharteses ose shartesa. Perpiqu me mire te varesh duke e tepruar ne kenaqesine tende, sesa te mbytesh dhe te shkosh pa te.

Proza te paperfunduara

I fundmi Skandërbe*

Ku janë orat dhe nuset? Shtojzovallet e zanat ku janë? S'po flitet ma për vallet e tyne? As për sytë e tyne që të shitojnë a të bajnë fatbardhë, s'po flitet ma...

27. VII. 1938

**) Skënder Luarasi: Migjeni. Vepra. Tiranë 1957., Dorëshkrimi ne Fondin Migjeni.*

Ik, moj flutur*

Ik! Ik, moj flutur, se do te digjesh!
Se ke me ra në gyp të llambës dhe me flakët e
saj ke me u djegë.
Por flutura s'dëgjon, sillet, silet e sillet.
Dhe m'atë të sjellun shkrepet për gyp, largohet,
shkrepet, rrotullohet rreth llambes dh(j)etë herë
për m'i shkrepë...

**) Vehbi Bala: Migjeni, Portret. - Monografi, Tiranë 1974. Fillimi i nje proze poetike, shkruar nga Migjeni mbi faqen e fundit te nje libri te bibliotekes se tij. Shtepia-muze e Migjenit, Shkoder.*